





MISIONI

Të fuqizojmë profesionin e kontabilitetit dhe auditimit [në sektorin privat dhe publik] në Kosovë dhe regjion duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për të mirën e shoqërisë si përfitues i fundit.

VIZIONI

Shoqatë lidere në avancimin e profesionit të kontabilitetit, auditimit dhe shërbimeve tjera të specializuara duke ofruar gjithmonë zgjedhjen më të mirë për profesionistët.

QËLLIMI

Zhvillimi i vazhdueshëm i programit të trajnimit i krahasueshëm me programet e shoqatave profesionale më eminente të kontabilitetit. Zhvillimi dhe avancimi i bazës së anëtarësisë të njohur për ekspertizë profesionale dhe standarde të larta etike. Anëtarësimi në organizata profesionale ndërkombëtare.

Anëtare me të drejta të plota në:





ME JU GJATË DEKADËS SË TRETË

Viti 2022 paraqet fillimin e një dekade gjatë të cilës ShKÇAK do të vazhdojë rrugën drejt përmbushjes së misionit të saj për të fuqizuar profesionin e kontabilitetit dhe auditimit, duke promovuar standardet më të larta të etikës, edukimit, dhe ekselencës profesionale për qëllim të mbrojtjes së interesit publik.

Përgjatë 20 viteve të zhvillimit të profesionit, Shoqata ka bashkuar individë rreth idesë së gjithëpërfshirjes në një komunitet i cili punon në zhvillim profesional, promovim të transparencës financiare dhe etikës profesionale.

Ndryshimet në ambientin ku kontabilistët dhe auditorët veprojnë po sjellin edhe ndryshime në mënyrën e ushtrimit të këtij profesioni. ShKÇAK ecë me këto trende në mënyrë që anëtarët e saj të jenë në nivel të zhvillimeve globale.

Teknologjitë e reja dhe fokusi i vazhdueshëm në inkorporimin e tyre në procese të punës, kërkojnë që kontabilistët dhe auditorët të kenë aftësi dhe kapacitete më të zgjeruara. Në fillimet e dekadës së re ShKÇAK do të jetë e përqëndruar në ofrimin e moduleve të reja të trajnimeve me fokus në Auditimin e Teknologjisë Informative; trajnime praktike (softuerike); Analiza Financiare dhe të Kostos dhe trajnime të tjera relevante që do të ndihmojnë në avancimin profesional të anëtarëve tanë ekzistues dhe atyre potencial.

Digjitalizimi i proceseve të ShKÇAK si një ndër prioritetet e Shoqatës dhe një hap i rëndësishëm dhe i domosdoshëm i referohet një transformimi të përgjithshëm të aktiviteteve organizative që synojnë shfrytëzimin e mundësive të krijuara nga teknologjitë dhe të dhënat digjitale, për të qenë sa më afër dhe efikas me anëtarët dhe studentët.

ShKÇAK gjithmonë do të angazhohet që të ofrojë shërbime që paraqesin vlerë të shtuar për anëtarin e saj dhe të sigurohet që shërbimet e anëtarëve të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në këtë drejtim Shoqata do të avancojë tutje sistemin e menaxhimit të cilësisë dhe Edukimit të Vazhdueshëm Profesional sipas zhvillimeve të reja vendore dhe ndërkombëtare, e këtë do ta mundësojë duke bashkëpunuar dhe mbajtur kontaktet e vazhdueshme me rregullatorët dhe standard-vënësit vendor dhe global.

Situata e krijuar nga pasojat e Covid 19, lufta në Ukrainë dhe inflacioni i lartë në vend kanë reflektuar edhe në profesionin tonë, por puna jonë e përbashkët dhe profesionalizimi i dëshmuar nga të gjithë ne mbetet udhërrefyesi ynë për të tejkaluar edhe këtë situatë.

Vendimet dhe veprimet tona strategjike vazhdojnë të na pozicionojnë dhe të kemi reputacion të lartë si në vend ashtu dhe jashtë saj.

PËRMBAJTJA

Fjala e kryetarit	6
Mesazh nga Drejtoresha Ekzekutive	8
Qeverisja e mirë	20
Aktivitetet vendore	28
Bashkëpunimi rajonal	38
ShKÇAK aktive në sferën globale	39
Struktura organizative e ShKÇAK	43
Studentët e vitit 2022	44
Raportet e Komisioneve	45
Raport nga Komisioni për Nominime	47
Raport nga Komisioni për Sjellje dhe Diciplinë	48
Raport nga Komisioni për Auditorë Ligjor	50
Raport nga Komisioni për Kontabilistë të Certifikuar	51
Raport nga Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale	52
Raport nga Komisioni për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet	53
Raport nga Komisioni për Tatime	54
Të dhëna Statistikore 2022	57
Galeri	60

SHKURTESAT

AAT	Shoqata e Teknikëve të Kontabilitetit të Britanisë së Madhe
ACCA	Shoqata e Auditorëve të Çertifikuar të Anglisë
AICPA	Instituti Amerikan i Kontabilistëve Publik të Çertifikuar
AKK	Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
BQK	Banka Qendrore e Kosovës
CAP	Paneli Këshillues mbi Pajtueshmërinë i FNK
CIPFA	Instituti e Licencuar për Financa Publike, Kontabilitet dhe Auditim
DOA (SMO)	Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë të FNK
EFAA	Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM
FCM	Federata e Kontabilistëve të Mesdheut
FNK	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IAAB	Instituti IAAB
IEKA	Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar
IFC	Korporata Financiare Ndërkombëtare
KKRF	Këshilli Kosovar për Raportim Financiar
MFPT	Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve
MINT	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
NVM	Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme
OEAK	Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë
OEK	Oda Ekonomike e Kosovës
PAODC	Komisioni i FNK për Zhvillimin e Organizatave Profesionale të Kontabilitetit
PVM	Praktikat e Vogla dhe të Mesme
QRRF	Qendra për Reforma në Raportim Financiar
SNA	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNE	Standardet Ndërkombëtare të Edukimit
SNK	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNRF	Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
ShKÇAK	Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës
ZKA	Zyra Kombëtare e Auditimit

FJALA E KRYETARIT



Të nderuar anëtarë,

Së pari, dua të ju falënderoj të gjithë për përkushtimin dhe punën e tuaj të vazhdueshme gjatë këtij viti. Si kryetar i Bordit të Shoqatës, jam i nderuar të jem pjesë e një komuniteti të tillë profesionistësh të suksesshëm.

Në këtë vit, kam pasur privilegjin të takohem dhe të bisedojë me shumë anëtarë, studentë, punëdhënës dhe akterë të tjerë relevant të komunitetit ku ne përkasim. Dy gjëra janë shumë të dukshme për mua. Së pari, ne po jetojmë në një kohë ndryshimesh dhe sfidash të paprecedentë për profesionin e kontabilitetit dhe auditimit. Së dyti, ShKÇAK, vlerat – përgjegjshmëria, diversiteti, integriteti, inovacioni dhe mundësia – janë çdoherë e në rritje.

Teknologjia është duke e ndryshuar mënyrën e funksionimit të profesionit. Softuerët janë duke eliminuar pjesët e thjeshta dhe të zakonshme të kontabilitetit dhe po e mundëson thjeshtimin e proceseve të ndërlikuara në këtë profesion. Teknologjia tani më është duke transformuar llojet e shërbimeve që kontabilistët mund t'u ofrojnë klientëve të tyre, duke ofruar shërbime konsulente të vlefshme në kontabilitet, këshilla për rritje të bizneseve dhe planifikim strategjik. Kontabilistët gjithashtu tani ofrojnë këshilla lidhur me tatime, likuiditetin, kreditë, buxhetimin, indikatorët e performancës dhe planifikimet financiare.

Teknologjia është ajo që është duke e ridefinuar profesionin e kontabilistit, të gjithë kontabilistët që vendosin të përqafojnë ndryshimin do të kenë mundësi të panumërta të gëzojnë role të ndryshme si mentor, ligjërues si dhe konsulentë të besueshëm për klientët e tyre.

Vlenë të theksoj se janë dy trende aktuale që janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit: digjitalizimi dhe raportimi jo-financiar.

Digjitalizimi është duke e transformuar profesionin duke e bërë çdo profesionist, qoftë kontabilist dhe auditor edhe ekspert të teknologjisë informative. Raportimi jo-financiar duhet të shikohet si një shërbim i ri që do të ofrohet në një të ardhme të afërme nga profesionistët, qoftë si përgatitës apo auditues i informatave dhe raporteve jo-financiar.

Si profesionist, kam tentuar që të jam dhe veproj aty ku janë zhvilluar ngjarje të rëndësishme për profesionin, andaj jam krenar që jam pjesë e ShKÇAK.

Profesioni ynë është gjithmonë në një vijë lineare, RRIJTJE, ZHVILLIM, ARRITJE.

Ju falënderoj përsëri për punën tuaj të palodhur tashmë në dy dekada dhe jam i sigurt që do të vazhdojmë të punojmë së bashku për të arritur suksese dhe për shumë dekada të tjera.



MESAZH NGA DREJTORESHA EKZEKUTIVE



Të nderuar anëtarë,

ShKÇAK gjithmonë ka vënë theks të vecantë në mbështetjen e anëtarëve të saj, dhe viti i kaluar nuk ishte përjashtim. Edhe këtë vit ne i shtuam përpjekjet tona për të siguruar që anëtarët tanë janë duke ofruar nivelin më të lartë të shërbimit për klientët e tyre.

Profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit po punojnë në një ekonomi globale që po ndryshon me shpejtësi. Ndryshimet në rregullore, ligjet tatimore dhe praktikën e biznesit janë duke ndikuar vazhdimisht në praktikën dhe kërkesat e shtuara për të gjithë ne.

Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit ka një rol të rëndësishëm në promovimin e besimit dhe transparencës financiare. Kjo është veçanërisht

e rëndësishme në klimën aktuale, ku ka një kërkesë në rritje për llogaridhënie dhe praktika etike të biznesit. Shoqata jonë është e përkushtuar të ruaj standardet më të larta të profesionalizmit, integritetit dhe sjelljes etike në industri, dhe ne në vazhdimësi punojmë për të promovuar këto vlera në nivel vendor dhe atë global.

Raportimi i qëndrueshmërisë, ai social, mjedisor dhe i qeverisjes (ESG) është bërë një çështje gjithnjë e më e rëndësishme për profesionin tonë dhe është një temë kyçe në diskutimet globale për të ardhmen e profesionit. Ka shumë arsye pse kontabilistët dhe auditorët duhet të jenë prijës në raportimin social dhe të qëndrueshmërisë. Së pari, si ekspertë të raportimit financiar dhe pajtueshmërisë, kontabilistët dhe auditorët kanë një perspektivë unike se si të dhënat mund të përdoren për të gjurmuar, matur dhe komunikuar progresin dhe suksesin në iniciativat e qëndrueshmërisë. Së dyti, si drejtues në sektorin financiar, kontabilistët kanë fuqinë për të nxitur ndryshimin duke vendosur dhe promovuar praktikën më të mira. Së fundi, kontabilistët kanë një interes të veçantë për të kuptuar dhe zbutur rrezikun që lidhet me iniciativat e qëndrueshmërisë, gjë që i bën ata zëra kritikë në dialogun rreth raportimit social.

Ne kemi punuar me anëtarët tanë për t'i informuar mbi këto iniciativa në mënyrë që të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për të ofruar shërbime me vlerë të shtuar në këtë fushë.

Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit po ashtu është duke u sfiduar me përdorimin në rritje të teknologjisë në të gjithë industrinë. Profesionistët po kalojnë në një periudhë shumë dinamike dhe gjithnjë e më konkurruese. Për të qëndruar konkurrues, përdorimi i teknologjive dhe strategjive të reja është i domosdoshëm dhe mundëson të jemi më të shkathët dhe më të përgjegjshëm në kushtet aktuale të tregut.

Ne si ShKÇAK gjatë këtij viti kemi punuar jo vetëm në digjitalizimin e proceseve brenda shoqatës por gjithashtu në gjetjen e modaliteteve për të siguruar anëtarëve

tanë burimet dhe trajnimet e nevojshme për të qëndruar në hap me këto zhvillime.

Sigurimi i cilësisë çdo vit është duke u forcuar dhe si rezultat i kësaj pune, anëtarët tanë kanë vazhduar të kenë reputacion të lartë profesional.

Anëtarët e ShKÇAK kanë demonstruar shkathtësi në përshtatjen me mjedisin në ndryshim dhe gjetjen e mënyrave të reja për të ofruar vlerë për klientët e tyre. Nuk kam asnjë dyshim se puna dhe përkushtimi i anëtarëve tanë do të vazhdojë të jetë një forcë shtytëse për shoqatën tonë në vitet në vijim.

Si përfundim, ndërsa shikojmë përpara drejt së ardhmes, ne e dimë se do të ketë më shumë sfida për t'u përballur dhe më shumë mundësi për t'u shfrytëzuar. Por kam besim se, me mbështetjen dhe përkushtimin e anëtarëve tanë, ne do të vazhdojmë të udhëheqim rrugën në profesionin tonë.

Duke ju falenderuar secilit nga Ju pres që të vazhdojmë të punojmë së bashku për suksesin e profesionit tonë.



AKTIVITETET E SHKÇAK GJATË 2022

Aktivitetet e Shoqatës gjatë vitit 2022 kanë qenë të fokusuar në avancimin e profesionit që t'i shërbejë interesit publik, menaxhimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga anëtarët e Shoqatës, ofrimin e trajnimeve në lëmitë relevante të profesionit dhe fuqizimin e rolit të anëtarëve të Shoqatës.

Në përputhje me planin e punës për vitin 2022, Shoqata ka vazhduar të implementojë programet e edukimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit, të mbajë anëtarët të përditësuar me zhvillimet e fundit të profesionit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional dhe të sigurojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët përmes menaxhimit të cilësisë.

Pjesë e rëndësishme e strategjisë së Shoqatës është digjitalizimi i proceseve dhe në këtë drejtim Anëtarët e ShKÇAK në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve kanë marrë vendim për të aprovuar projektin e digjitalizimit.



Prioritet i ShKÇAK gjithmonë është komunikimi me anëtarin. ShKÇAK në vazhdimësi mbanë të informuar anëtarët me të rejat dhe ngjarjet relevante që kanë të bëjnë me profesionin në vend, rajon dhe botë, duke kontribuar kështu në zhvillimin e një profesioni të qëndrueshëm si në sektorin privat ashtu dhe në atë publik.

Duke qenë se një ndër shtyllat e Strategjisë së ShKÇAK është zhvillimi i profesionistëve të së ardhmes, në fokus të këtij viti ka qenë dhe zhvillimi i moduleve specifike sipas kërkesave të tregut të punës, module të cilat do të shërbejnë në përgatitjen e të rinjëve për tregun e punës.

Bizneset dhe institucionet tash e sa vite janë të informuar mbi vlerat e anëtarëve të ShKÇAK si profesionistë me etikë dhe integritet. Kjo gjë ka rezultuar me një rritje të konsiderueshme të konkurseve të punës në fushën e kontabilitetit dhe auditimit, të cilat kanë kërkuar specifikisht profesionistë që posedojnë thirrje profesionale nga Shoqata.



Gjatë këtij viti ShKÇAK shenoi 20 vjetorin e themelimit të saj, pjesë e së cilës ishin anëtarët e saj, bashkëpunëtorë, personalitete të larta nga institucionet vendore dhe ndërkombëtare.

Ishte nder i veçantë për anëtarët e ShKÇAK që hapja e ceremonisë të bëhej nga Kryeministri i Republikës së Kosovës Z. Albin Kurti dhe të adresohen mesazhe nga Z. Jörn Rohde, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë; Z. Nazmi Pllana, Kryetar i ShKÇAK; Z. Alan Jonson - Kryetar i Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve dhe Auditorëve; Z. Giorgio De Giorgi - Kryetar i Federatës së Kontabilistëve të Mesdheut dhe Z. Salvador Marin - Kryetar i Federatës Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM; Z. Massimiliano Paolucci, Menaxher i Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut; Znj. Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovë; Z. Joshua Mike, Drejtor i zyrës për Zhvillim Ekonomik në USAID dhe Z. Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë ceremonisë ShKÇAK ndau mirënjohje në shenjë falënderimi për kontributin e dhënë në zhvillimin e profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit institucioneve, bashkëpunëtorëve vendor dhe ndërkombëtar, anëtarëve, kryetarëve dhe anëtarve të bordit, anëtarëve të komisioneve si dhe personelit të zyrës që kontribuan ndër vite në suksesin e Shoqatës.



Drejtoresha Ezekutive e ShKÇAK Znj. Ardiana Bunjaku

“Fuqia e Shoqatës sonë buron nga anëtarët e saj, angazhimi dhe përkushtimi i tyre për avancimin e profesionit, për çka jam mirënjohëse dhe i falënderoj për punën profesionale të dëshmuar për këto 20 vjet ekzistencë. Që nga themelimi, synimi ynë ishte të jemi lider të profesionit, gjë që besoj se e kemi dëshmuar në 20 vitet e fundit. Gjatë këtij rrugëtimi ne nuk ishim të vetëm. Sot dua të shfrytëzoj këtë ceremoni të falënderoj nga thellësia e zemrës të gjithë partnerët tanë në zhvillim, kosovarë dhe ndërkombëtarë, pa të cilët ne nuk do të kishim arritur këtu ku jemi”...



Kryeministri i Republikës së Kosovës Z. Albin Kurti

“Kam nderin të jem bashkë me ju për të shënuar 20 vjetorin e themelimit të ShKÇAK. Të dashur anëtarë të Shoqatës, profesioni i juaj është shumë i rëndësishëm për të mbajtur Qeverinë të përgjegjshme dhe transparente, por edhe llogaridhënëse para qytetarëve. Përmes raportimit të mirëfilltë financiar ngritet besimi i qytetarëve te institucionet tona dhe përmirësohet klima e të bërit biznes në Kosovë. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në tërheqjen e investimeve të cilat janë shumë të nevojshme për hapjen e vendeve të reja të punës dhe zhvillimin e

qëndrueshëm ekonomik të vendit tonë. Ju keni dëshmuar qysh në vitet e para të pasluftës se arritja e standardeve ndërkombëtare dhe integrimi në institucionet ndërkombëtare nuk është i paarrtshëm. Anëtarësimi në federata ndërkombëtare të profesionit si Federata Ndërkombëtare e Kontabilitetit (IFAC), Federata Mesdhetare e Kontabilistëve (FCM) dhe Federata Evropiane të Kontabilistëve dhe Auditorëve për përdorim të Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (EFAA) dëshmon më së miri për punën tuaj të pakursyer”...



Auditore e Përgjithshme e Republikës së Kosovës Znj. Vlorë Spanca

“Është kënaqësi të jem prezente sot, në festimin e 20 vjetorit të themelimit të Shoqatës së Kontabilistëve dhe Auditorëve të Certifikuar të Republikës së Kosovës. 20 vite më parë, themelimi i kësaj shoqate i vendosi bazën për zhvillimin profesional të kontabilistëve dhe auditorëve të Kosovës, të cilët me pas do t'i shërbenin vendit tonë në menaxhimin e financave si në sektorin privat e ashtu edhe në atë publik”...



Jörn Rohde, Ambasador i Republikës Federale të Gjermanisë në Kosovë

“Unë mendoj se tashmë janë thënë të gjitha pse një shoqatë në një shoqëri moderne është e rëndësishme, ka të bëjë me transparencën, ka të bëjë me pjesëmarrjen; ju listuat të gjithë partnerët tuaj ndërkombëtarë dhe kjo dëshmon që keni bërë një rrugë të gjatë në 20 vitet e fundit dhe unë do të doja të ju përgëzoja dhe gjithashtu t’ju sfidoja ose t’ju pyes: që në një mjedis profesional gjithnjë në ndryshim, në shekullin 21 ku ne jetojmë, ku ligjet ndryshojnë gjatë gjithë kohës, mendoj se është detyrë që organizatat profesionale të sfidojnë qeverinë në legjislacionet ku ata janë

përgjegjës, sepse një organizatë profesionale funksionale vazhdimisht duhet të jetë në ndërveprim pozitiv me qeverinë për t’i përditësuar ligjet e saj.

Unë dua t’ju uroj gjithë të mirat në 20 vitet e ardhshme dhe do të doja ta mbyllja me një citim pak të ndryshuar nga Lenini. Lenini ka thënë se “vetëbesimi është i mirë, kontrolli është më i mirë” dhe unë do të thosha “vetëbesimi është i mirë, auditorët janë më të mirë”...



Kryetari i ShKÇAK Z. Nazmi Pllana

“Kam nderin që sot, në këtë përvjetor të njëzetë të Shoqatës sonë, si kryetar i Bordit, dhe si anëtar aktiv që nga fillimet e Shoqatës, t’i them disa fjalë për të kujtuar rrugëtimin e saj deri më tani. Misioni i Shoqatës është që të zhvillojë dhe avancojë një organizatë profesionale dhe konkurruese edhe në tregun ndërkombëtar, që përmbush standardet më të larta profesionale dhe etike, si dhe perfeksionon performancën organizative përmes menaxhimit financiar, sigurisë dhe ekspertizës së specializuar. Ne veprojmë me integritet, objektivizëm dhe me përkushtim ndaj cilësisë dhe interesit publik”...



Z. Alan Jonhson, Kryetar, Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve dhe Auditorëve

” Në emër të profesionit global të kontabilitetit dhe auditimit po ju dërgoj urimet e mia të sinqerta me rastin e festimit të 20-vjetorit. Ky është gjithashtu 19 vjetori i anëtarësimit të ShKÇAK në IFAC, këto janë momente të rëndësishme me të cilat duhet të jeni krenarë. Profesioni i kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë ka identifikuar qartë nevojën e kontabilistëve dhe auditorëve profesionistë që të bashkohen për të mbështetur funksionimin efektiv të bizneseve dhe gjithashtu të angazhohen për të fuqizuar profesionin e kontabilitetit dhe

auditimit në vendin tuaj.

Vizioni që ka treguar ShKÇAK është i jashtëzakonshëm dhe po e ndihmon Kosovën që të krijojë kushtet e nevojshme për zhvillim të qëndrueshëm të vendit.

Profesioni ynë ka një të ardhme të ndritur përpara dhe falënderoj udhëheqësit e tanishëm dhe të kaluar të ShKÇAK dhe gjithashtu çdo anëtar të ShKÇAK të cilët janë pjesë e rëndësishme e saj. Faleminderit shumë për gjithçka që po bëni dhe shpresoj të keni një festë të mrekullueshme”...



Z. Giorgio De Giorgi, Kryetar, Federata e Kontabilistëve të Mesdheut

“Kam kënaqësinë dhe privilegjin t’ju uroj për 20 vjetorin. Kufizimet e Covid 19 për sa i përket udhëtimit nuk më lejuan të jem personalisht me ju, por po ju dërgoj këtë mesazh të shkurtër në mënyrë që të jem me ju shpirtërisht, nëse jo personalisht. Roli i SHKÇAK është gjithnjë e më i rëndësishëm veçanërisht në shpërndarjen e shpejtë të informacionit nga njëri tek tjetri, ndaj kontabilistët dhe auditorët brenda dhe jashtë vendit duhet të mbështeten në informacionin e duhur nga një subjekt superior si rasti i SHKÇAK në Kosovë që mund t’i atribuojë besueshmëri dhe

siguri. Ne duhet të shikojmë botën, jashtë kopshtit tonë të vogël, duhet të shikojmë më tej, FCM është një nga mekanizmat që mund të përdorim për të zgjeruar aktivitetin tonë përtej kufijve tanë dhe FCM u është mirënjohëse organizatave si SHKÇAK e cila është një anëtare e vjetër e Federatës. Ne do të punojmë së bashku edhe për 20 vjet të tjera, unë kam regjistruar tashmë në ditarin tim 40 vjetorin tuaj. Urime edhe njëherë për 20 vjetorin tuaj dhe shpresoj që së shpejti të shihemi personalisht. Mirupafshim nga presidenti i FCM”...



Salvador Marin, Kryetar, Federata Evropiane e Kontabilistëve dhe Auditorëve për NVM

“Së pari dëshiroj t’ju kërkoj falje që nuk munda të marr pjesë personalisht në këtë ngjarje të rëndësishme. Do të doja t’ju falënderoja që më lejuan të dërgoj një fjalë në këtë takim të rëndësishëm. SHKÇAK ka kontribuar ndjeshëm në objektivat thelbësorë të EFAA-s në promovimin e rolit të profesionit të kontabilitetit, si këshilltar i besuar i NVM-ve dhe në shërbim të interesit publik dhe zhvillimit ekonomik. SHKÇAK punon në mënyrë specifike në promovimin e standardeve më të larta të etikës, edukimit dhe ekselencës

profesionale. Reformat në praktikë janë të një rëndësie të veçantë. EFAA për SME-të është zëri i praktikave të vogla dhe të mesme të kontabilitetit dhe auditimit në Evropë. Së bashku me SHKÇAK, ne punojmë për të siguruar që cilësia e lartë e shërbimeve të ofruara nga PVM-të njihet si kritike për mirëqenien dhe rimëkëmbjen e NVM-ve. Mbështetja e vazhdueshme e SHKÇAK vlerësohet shumë. Urime për këtë përvjetor, ne do të vazhdojmë të punojmë së bashku edhe në të ardhmen. Faleminderit shumë”...



Massimiliano Paolucci, Menaxher i Bankës Botërore për Kosovë dhe Maqedoni të Veriut

“Faleminderit që më ftuat të jem pjesë e këtij event, ku SHKÇAK feston 20 vjetorin e saj. Nga trajnimet e ndjekura jam një ekonomist politik, por më herët kam qenë kontabilist profesionist. Pra, është shumë emocionuese të jesh këtu të shohësh një komunitet kaq të madh që kontribuon për të ndihmuar në krijimin dhe fuqizimin e themeleve të Republikës së Kosovës përmes aktiviteteve të saj që synojnë forcimin e transparencës, efikasitetit dhe llogaridhënies. Si Bankë Botërore, jemi të lumtur që kemi kontribuar

financiarisht dhe teknikisht në fuqizimin e raportimit financiar të korporatave në Kosovë përmes SHKÇAK që nga themelimi i saj në vitin 2001. Dëshiroj të përgëzoj SHKÇAK për shënimin e 20 vjetorit, me urimet më të mira për avancimin e vazhdueshëm të Shoqatë dhe profesionit të auditimit dhe kontabilitetit...



Drejtor i zyrës për Zhvillim Ekonomik, USAID Kosovë Z. Joshua Mike

“Është një nder për mua që jem këtu sonte për të përfaqësuar USAID-in, veçanërisht në festimin e 20 vjetorit tuaj. Rreth 20 vjet më parë USAID-i mbështeti SHKÇAK-në duke i dhënë një grant për të mbështetur zhvillimin e materialeve, çertifikimet profesionale, zhvillimin e trajnimeve dhe ndërtimin e kapaciteteve të një institucioni i cili do t’iu shërbejë nevojave të sektorit publik dhe privat dhe për këtë jemi shumë krenarë. Për këtë periudhë ju keni arritur vetëqëndrueshmëri të jashtëzakonshme dhe pikërisht këtë lloj kapaciteti drejtues dhe organizativ dëshirojmë të

shohim. Ju nuk vareni më nga donatorët dhe ju keni dëshmuar vlerën e shtuar për anëtarët tuaj si në sektorin privat ashtu edhe në sektorin publik dhe për këtë ne ndihemi krenarë. Prandaj ju falënderoj shumë për udhëheqjen tuaj dhe ndihmën për të krijuar një sektor privat konkurrues dhe në rritje. Sot, anëtarësimi i SHKÇAK në organizatat ndërkombëtare si IFAC është vetëm një dëshmi dhe flet për shërbimet e cilësisë së lartë që ofroni dhe duhet të them se numri prej 8000 anëtarë është shumë mbresëlënës. Nëpërmjet trajnimeve dhe programeve që vazhdoni të ofroni, duke përmirësuar raportimin financiar dhe duke fuqizuar atë gjatë viteve për komunitetin dhe vendin tuaj, në emër të USAID-it dua t’ju përgëzoj dhe ju urojtë vazhdoni me suksese edhe shumë vite të tjera...



Ish-Kryetarja e Bordit të SHKÇAK Znj. Shpresa Mustafa

“Unë sot jam e emocionuar, sot jam kthyer 20 vite prapa dhe mund të them se jam krenare që jam pjesë e SHKÇAK. Ju falënderoj të gjithëve nga zemra. Anëtarët të cilët me punën e tyre profesionale na bëjnë të jemi këta që jemi sotlider në profesion.

Falënderoj institucionet e vendit, donatorët, punëdhënësit pa të cilët I tërë ky rrugëtim do të ishte më i vështirë”...



Dritan Fino, Kryetar i Bordit të Mbikëqyrjes Publike të Republikës së Shqipërisë

“Duke ju uruar nga zemra, gëzuar 20 vjetorin organizatës suaj e sa më shumë arritje të mëtejshme, si dhe duke falënderuar organizatorët e këtij eventit për ftesën si dhe për mikpritjen e treguar ndaj nesh, unë, në cilësinë e Kryetarit të BMP-së së Republikës së Shqipërisë, ndihem shumë i nderuar që në përvjetorin e 20-të të institucionit të SHKÇAK, të nënshkruaja një memorandum bashkëpunimi mes nesh, i cili është në interesin e përbashkët të të dy institucioneve që të bashkëpunojmë në shkëmbimin e përvojave tona në lidhje me zhvillimin e profesionit të

kontabilitetit dhe auditimit. Bashkëpunimi me SHKÇAK, e cila është organizata e parë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë si dhe e vetmja që është anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kontabilistëve (FNK), jam i sigurt që do të na ndihmojë në mënyrë reciproke në përmirësimin e cilësisë, saktësisë dhe besueshmërisë së profesionit të auditimit nëpërmjet rregullimit dhe mbikëqyrjes së profesionit, në mënyrë që të mbrojmë investitorët, të ndihmojmë në forcimin e besimit të publikut në raportimin financiar dhe të rrisim besimin e investitorëve në tregjet tona”...





QEVERISJA E MIRË

ShKÇAK implementon objektivat strategjike përmes Zyrës Ekzekutive, Bordit dhe Komisioneve të saj.

Kuvendi i ShKÇAK – si organi më i lartë qeverisës i Shoqatës, i përbërë nga anëtarët aktiv të ShKÇAK në Mbledhjen e Kuvendit të Anëtarëve të vitit 2022, zgjodhi anëtarët e rinj të Bordit të cilët do ta udhëheqin ShKÇAK-në për mandatin 2022-2024:

Nazmi Pllana – Kryetar i Bordit, Kontabilist i Çertifikuar

Adrian Alo – Auditor i Çertifikuar

Elvira Ibrahim Hoti – Auditore e Çertifikuar

Lulzim Krasniqi – Auditor Ligjor

Lulzim Zeka – Auditor Ligjor

Mentor Hyseni – Auditor i Brendshëm i Çertifikuar

Sakip Imeri – Kontabilist i Çertifikuar



Gjatë Kuvendit u zgjodhën anëtarët e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë dhe Komisionit për Nominime:

Komisioni për Nominime:

- Bashkim Uka
- Lindita Matoshi
- Teuta Ukshini Aliu
- Tomorr Zhaveli

Komisioni për Sjellje dhe Dicipinë:

- Astrit Shehu
- Edona Uka Paci
- Kaltrina Kadriu Xhema
- Merita Gashi
- Nekibe Haziri

Anëtarët e Kuvendit përveç aprovimit të aktiviteteve të vitit 2021, raportit të pasqyrave financiare të audituara për vitin 2021, si dhe planin e punës dhe buxhetin për vitin 2022, ata morën vendimin strategjik për transformimin digjital si investim kapital i cili do të implementohet në periudhën 2022-2024.



Për të garantuar që proceset e ShKÇAK janë në përputhje me legjislacionin vendor dhe me zhvillimet e fundit të profesionit Bordi i ShKÇAK përmes Zyrës Ekzekutive dhe Komisioneve të saj në vazhdimësi bën azhurnimin e rregulloreve dhe proceseve për të siguruar qeverisje të mirë dhe funksionale.



Sipas Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim i cili i referohet kërkesave të mbikëqyrjes së Shoqatave, ShKÇAK edhe njëherë demonstroi profesionalizimin e saj në përmbushjen e kërkesave ndërkombëtare që dalin nga Deklaratat e Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të lëshuara nga Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve (FNK). Si rezultat i kësaj, Instituti Amerikan i Auditorëve të Çertifikuar Publik (AICPA) pas monitorimit të punës së ShKÇAK për periudhën 2015-2020 i propozoi KKRF që ShKÇAK të i vazhdohet licenca, me ç'rast në raportin tyre, ndër të tjerash, AICPA thekson “dëshirojmë të përgëzojmë ShKÇAK për progresin e rëndësishëm që ka shënuar që nga themelimi i saj në vitin 2001, dhe ta urojmë për arritjet dhe sukseset e shumta gjatë kësaj kohe. Ne besojmë se, pas shqyrtimit të raportit nga ana juaj, ju do të vazhdoni të njihni ShKÇAK sipas dispozitave të Ligjit dhe Udhëzimit Administrativ.”

Gjatë këtij viti është azhurnuar rregullorja për Edukim duke u harmonizuar me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit (DOA 2) e cila përmbanë dispozita specifike të rëndësishme dhe të qarta për sa i përket, trajnimeve, provimeve, Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Kjo rregullore do të hyjë në fuqi në vitin 2023.



MENAXHIMI I CILËSISË PËR PAJTUESHMËRI ME STANDARDE (MCPS)

ShKÇAK vazhdon të sigurojë cilësinë e shërbimeve të ofruara nga anëtarët përmes menaxhimit të cilësisë.

Menaxhimi i cilësisë për pajtueshmëri me standarde ndihmon dhe siguron anëtarët nëse gjatë punës së tyre kanë vepruar në përputhje me kërkesat e Standardeve dhe Kodin e Etikës. Kjo ndihmon në ruajtjen e reputacionit të anëtareve dhe profesionit dhe nga ana tjetër rrit besimin e përdoruesve të raporteve të auditimit, pasqyrave financiare si dhe edukon në këtë aspekt publikun e gjerë dhe gjeneratat e reja mbi vlerat që posedon anëtari i ShKÇAK.



Raportimi me cilësi të lartë siguron informacion të dobishëm për vendimmarrësit, i cili është i rëndësishëm dhe përfaqëson me besnikëri realitetin ekonomik të aktiviteteve të kompanisë gjatë periudhës së raportimit, si dhe gjendjen financiare të kompanisë në fund të periudhës. Menaxhimi i cilësisë gjithashtu nënkëton ndërgjegjsimin e bizneseve mbi sigurinë dhe kualitetin që ofrojnë anëtarët tanë në ofrimin e shërbimeve të tyre.

ShKÇAK ka vazhduar të jetë e fokusuar në shtimin e vlerës për anëtarë nëpërmjet digjitalizimit të procesit të raportimit vjetor të anëtarëve të Shoqatës. Ky vit shënon vitin e dytë që anëtarët e shoqatës, AL, AC/KC dhe ABC, kanë raportuar aktivitetet e tyre vjetore në platformë elektronike të raportimit të zhvilluar nga shoqata (www.scaakreport.org).

Pas një raportimi të suksesshëm të aktiviteteve vjetore nga anëtarët për vitin raportues 2021, ShKÇAK ka përmbledhur informatat nga raportimi duke përzgjedhur anëtarët për menaxhim të cilësisë në bazë të thirrjes profesionale, si dhe ka përgatitur Raportin vjetor për mbarëvajtjen e procesit të raportimit të anëtarëve, të cilat janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni për MCPS.

Gjatë këtij viti janë rishikuar për pajtueshmëri me standardet anëtarët të cilët mbajnë thirrjen profesionale AL, AC/KC dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet janë komunikuar dhe shqyrtuar me anëtarë. Pas diskutimit të gjetjeve dhe rekomandimeve janë përgatitur raportet finale të vlerësimit, të cilat janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komisioni për MCPS dhe të cilat i janë dorëzuar anëtarëve.



PROGRAMET ÇERTIFIKUESE TË SHKÇAK

Shoqata ka vazhduar të ofrojë programet e edukimit në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Edukimit, të mbajë anëtarët të përditësuar me zhvillimet e fundit të profesionit përmes Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

Sistemi online i mbajtjes së ligjëratave ka rezultuar deri më tani të jetë i suksesshëm edhe nga vlerësimet e kandidatëve edhe nga rezultatet e provimeve, për këtë arsye gjatë vitit 2022 pëveç zhvillimit të trajnimeve me prezencë fizike janë zhvilluar dhe trajnimet në mënyrë virtuale.



Në mënyrë që ShKÇAK të mbajë nivelin e lartë të trajnimeve dhe ligjëruesve të saj, në çdo sesion të trajnimeve ShKÇAK përgatit dhe dërgon tek anëtarët/studentët pyetësorët për vlerësimin e ligjëruesve.



ShKÇAK ka azhurnuar materialet sipas standardeve ndërkombëtare të edukimit (SNE); standadreve ndërkombëtare të raportimit financiar (SNRF) dhe standardeve ndërkombëtare të auditimit (SNA) dhe në të njejtën kohë janë informuar të gjithë anëtarët e saj të cilët janë në proces që ky material do të fillojë të implementohet gjatë vitit 2023.



EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL

Ruajtja, përmirësimi dhe zhvillimi sistematik e i vazhdueshëm i njohurive dhe aftësive është i domosdoshëm për progresin profesional të secilit anëtarë të cilët posedojnë thirrjet profesionale të ShKÇAK. Ndjekja e sesioneve të Edukimi të Vazhdueshëm Profesional mundëson anëtarëve ju mundëson rritjen e kredibilitetit për sa i takon angazhimit të tyre për të qenë liderë në industrinë e kontabilitetit dhe auditimit.

Shoqata në vazhdimësi ofron sesione të EVP me tema relevante për profesionistët e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë, të cilat janë bazuar në kërkesat e vetë profesionistëve, në zhvillimet dhe ndryshimet ligjore që kanë ndodhur në vend dhe në botë si dhe në çështje të rëndësishme që ka identifikuar Departamenti i Edukimit, Menaxhimit të Cilësisë dhe komisionet përkatëse të Shoqatës gjatë punës së tyre.

ShKÇAK gjithashtu ka vazhduar marrëveshjen me Zyrën Kombëtare të Auditimit përmes së cilës profesionistët e punësuar në këtë institucion do të mund të ndjekin sesionet e EVP të Shoqatës. Përmes përditësimit të njohurive të profesionistëve të këtij institucioni, ShKÇAK kontribuon në përmirësimin e transparencës, llogaridhënies dhe menaxhimit të parasë publike në të gjitha institucionet shtetërore.



EVP-të e realizuara gjatë vitit 2022:

- Përgatitja e Pasqyrave Financiare nga Kontabilistët e Çertifikuar (shembuj praktik); Roli dhe përgjegjësia e kontabilistit në nënshkrimin e Pasqyrave financiare.
- Paraqitja e përgjithshme e pasqyrave financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave kontabël dhe informacionet shpjeguese, bazuar në kërkesat e SNRF për NVM.
- Regjistrimi i “Notë Krediti” e lëshuar dhe “Notë Krediti” e pranuar, bazuar ne UA Nr. 03/2015 Neni 65 dhe termat në Formularin e Deklarimit të TVSH-së të dizajnuar nga ATK.
- Vështrim i përgjithshëm i auditimit të brendshëm të bazuar në rrezik; Vlerësimi i rrezikut nga auditorët e brendshëm dhe çasja e planit të auditimi bazuar në rrezik.
- Kontabiliteti i sektorit të ndërtimtarisë: aspekti tatimor dhe i raportimit financiar.
- SNRF 16-Lizingu SNK 38-Pasuritë jo-qarkulluese të patrupëzuara SNK 40-Prona Investuese.
- SNRF 9-Instrumentet financiare; SNRF 13-Matja e vlerës së drejtë.
- ISQM/SNMC 1 - Standardi ndërkombëtar për menaxhimin e cilësisë, menaxhimi i cilësisë për firmat e auditimit që kryejnë auditime apo rishikime të pasqyrave financiare, ose angazhime të tjera sigurie apo shërbime të lidhura.
- ISQM/SNMC 2 - Standardi ndërkombëtar për menaxhimin e cilësisë, rishikimet e cilësisë së angazhimit & ISA/SNA 220 (rishikuar) - Standardet ndërkombëtare të auditimit, menaxhimi i cilësisë në auditim të pasqyrave financiare.
- Ndryshimet në strukturën e biznesit dhe kontabilitetin e menaxhimit.
- 315 Identifikimi dhe vlerësimi i rrezikut të anomalisë materiale (i rishikuar); SNA 260 Komunikimi me personat e ngarkuar me qeverisjen.
- Auditimi i Teknologjisë Informative.



AKTIVITETET VENDORE

ShKÇAK është aktive në të gjitha zhvillimet vendore që kanë të bëjnë me avancimin e profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit me qëllim të mbrojtjes së interesit publik.

Gjatë vitit 2022 ShKÇAK ka përgatitur Rekomandimet mbi reformimin e sistemit të raportimit financiar dhe auditimit, avancimin e sistemit të MFP (PFM) dhe Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik në Republikën e Kosovës. ShKÇAK ka zhvilluar takime me të gjitha institucionet relevante të Republikës së Kosovës: me KKRF, MFPT, MINT, Njësinë Qendrore të Harmonizimit, Thesarin e Republikës së Kosovës, Auditorin e Përgjithshme dhe ATK, gjatë takimeve janë diskutuar rekomandimet si dhe është avokuar për zbatim të ligjshmërisë për mbrojtjen e interesit publik. ShKÇAK gjithashtu ka përgatitur reagimin publik ndaj Raportit Nr. 441/2021 të Avokatit të Popullit lidhur me ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim për shkelje të Nenit 3.1 (Parimet bazë të veprimtarisë së Avokatit të Popullit) dhe nenit 16.4 të Ligjit Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili është publikuar dhe është dërguar tek institucionet përkatëse.



ShKÇAK zhvilloi takim me Zëvendëskryeministrin e parë të Republikës së Kosovës për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog, Z. Besnik Bislimi ku diskutoi rreth avancimit dhe reformave të sistemit të raportimit financiar dhe auditimit në Kosovë sipas Direktivave përkatëse të Bashkimit Evropian, si dhe menaxhimit të financave

publike dhe auditimit të brendshëm në sektorin publik duke i dhënë fokus ngritjes së kapaciteteve profesionale, si dhe çështje të tjera në lidhje me profesionin e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë. Përfaqësuesit e ShKÇAK shprehën gatishmërinë e plotë për të mbështetur Qeverinë në përpjekjet e saj drejt harmonizimit të Standardeve Profesionale në Kosovë me kërkesat e Bashkimit Evropian si dhe i dorëzuan z. Bislimi: Rekomandimet mbi reformimin e sistemit të raportimit financiar dhe auditimit në Republikën e Kosovës si dhe Bashkëpunimin për avancim të sistemit të MFP (PFM) dhe Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik.

Për të shënuar Ditën e Profesionit të Kontabilitetit dhe Auditimit, gjatë muajit nëntor ShKÇAK organizoi Konferencën me temë “Trendet dhe Zhvillimet e Fundit në Profesion”, ku morën pjesë rreth 200 anëtarë dhe përfaqësues të institucioneve relevante nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar, Administrata Tatimore e Kosovës, Odat Ekonomike, Univeristeti i Prishtinës si dhe Shoqata të Teknologjisë Informative. Në kuadër të Konferencës u zhvilluan tre panele:



(KKRF); Z. Lulzim Zeka - Anëtar i Bordit të ShKÇAK dhe Anëtar i Komitetit për Auditim në EFAA.

Në Panelin 1 të moderuar nga Z. Arbër Hoti u diskutua mbi Ligjin për Raportim Financiar Kontabilitet dhe Auditim dhe iniciativat Globale për Raportim dhe Ngritje Transparencës me panelistët: Z. Nazmi Pllana - Kryetar i Bordit të ShKÇAK dhe Anëtar i Komitetit për Kontabilitet në EFAA; Z. Sokol Shasivari - UD Kryesues i Këshillit Kosovar për Raportim Financiar



Tatime në ShKÇAK; Znj. Nora Hasani - Drejtoreshë Ekzekutive në Odën Ekonomike Gjermano- Kosovare (OEGJK).

Në panelin 2 të moderuar nga Z. Blerim Pushkolli u diskutua mbi Reformat në Legjislacionin Tatimor dhe sfidat në zbatimin e tyre me panelistët: Panelistë: Z. Sami Salihu - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK); Z. Sakip Imeri - Anëtar i Bordit të ShKÇAK; Z. Mal Osmani - Menaxher i Tatimeve në Deloitte; Z. Fahri Breznica - Kryesues i Komisionit për



Në panelin 3 të moderuar nga Znj. Edona Perjuci u diskutua mbi Edukimin Profesional si domosdoshmëri e kohës me panelistët: Z. Driton Balaj - Dekan në Fakultetin Ekonomik, Universiteti i Prishtinës; Znj. Hana Qerimi - Nënkryetare e Bordit të STIKK; Znj. Leonora Kusari - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH); Znj. Albina Berisha - Enhancing Youth Employment Project (EYE).

ShKÇAK duke qenë anëtare në Odat Ekonomike të cilat veprojnë në Kosovë përfaqëson anëtarët e saj përmes pjesëmarrjes në cilësi të anëtarit të bordit apo anëtarë të komisioneve të ndryshme gjatë këtij viti ka qenë mjaft aktive në lidhje me zhvillimet dhe të rejat e fundit, duke kontribuar me rekomandime për ndryshime në legjislacion, në avokimin e rëndësisë së raportimit financiar, avansimit të profesionit të kontabilitetit dhe auditimit dhe çështje tjera me interes publik.

ShKÇAK ka vazhduar takimet me Odat Ekonomike në Kosovë aty ku është anëtare duke përfaqësuar në:

- Tryezën e rrumbullakët mbi “Avancimin e Legjislacionit të të bërit biznes”, me të gjithë anëtarët e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;
- Tryezën e rrumbullakët me datë mbi “Prioritetet e Financimit të BERZH” për vitin 2022, me Neil Taylor, Udhëheqës i Programit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovë, si panelist. Të moderuar nga Ramis Ahmetaj, Ekspert i Financave;
- Tryezën e diskutimit mbi Financimin e Qëndrueshëm, me Eriola Bibolli, drejtoreshë, ProCredit Bank dhe Anita Kovacic, drejtoreshë, Raiffeisen Bank;
- Forum diskutimi me Zëvendësministrin e Drejtësisë, Blerim Sallahu, Qerim Ademaj (Këshilli Gjyqësor i Kosovës), Chris Thompson (Programi i USAID për Drejtësi Komerciale) dhe Kujtesa Nezaj Shehu (Avokate);
- Forum diskutimi për FinTech, për të Ardhmën e Pagesave, me Sokol Havolli (Zëvendësguvernator, Banka Qendrore e Kosovës), Gazmend Selmani (Drejtor, PBC/ibas) dhe Astrit Leti (Drejtor i Operacioneve, TIVE);
- Tryezë të rrumbullakët mbi Ndikimi i Rregullativës për Mbrojtjen e të Dhënave Personale tek Bizneset;

- Forum diskutimi për procedurat e falimentimit dhe Gjykatën Komerciale, Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë dhe IFC;
- Takimin e Klasterit për Tatime dhe Taksa i mbajtur është diskutuar lidhur me planin e punës për vitin 2022 dhe prioritetet e klasterit;
- Në tryezë diskutimi e organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano Kosovare me datë është prezentuar publikimi nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) mbi Strategjinë për Kosovën 2022-2027;
- Është organizuar punëtori nga Oda Ekonomike Gjermano Kosovare me datë për “Siguria e IT në ndërmarrje kuptimi dhe zbatimi”;
- Është organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano Kosovare një takim të anëtarëve me Deputetet e Komisionit Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndermarresi dhe Tregti;
- Tryezë diskutimi e organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano Kosovare në bashkëpunim me Odën Ekonomike Austriake dhe me Odën Ekonomike Zvicëro-Kosovare temën: Arsim profesional të qëndrueshëm përmes sistemit dual të arsimit;
- Takimin e Komitetit për Tatime të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë ku u diskutua rreth nevojës për ndryshime në legjislacionin tatimor, doganor, biznesor dhe investime të huaja;
- Takimi i Klasterit për Tatime dhe Taksa në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare;
- Punëtorja “Siguria e IT në ndërmarrje kuptimi dhe zbatimi” në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare;
- Tryezë diskutimi “E-Commerce” në Odën Ekonomike Gjermano-Kosovare;
- Darka Gala me rastin e 10 vjetorit të Odës Ekonomike Gjermano-Kosovare;
- Diskutim mbi ‘Kontrollimin e Inflacionit’ në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë;
- Punëtori për Udhërrëfyesin e Ekonomisë Qarkore me Sektorin Privat në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë;
- Trajnimi , me trajner ndërkombëtarë të specializuar në fushën e PPP/FT. Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës kundër Krimit Ekonomik (PECK III) në bashkëpunim me NJIF organizon trajnim lidhur me Identifikimin e Rreziqeve të Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit (PPP/FT) kontabilistë, auditorë dhe këshilltarë tatimor dhe subjekte tjera raportuese;

- Seminar mbi Ligjin dhe Politikat e Konkurrencës;
- Diskutim mbi dixhitalizimin e Administratës Tatimore të Kosovës me Drejtorin e Përgjithshëm të ATK-së në Odën Ekonomike Amerikane në Kosovë;
- Paneli “Klima e Investimeve dhe Bashkëpunimi Rajonal” nga Oda Tregtare Kosovaro-Turke me rastin e përvjetorit të 14-të të themelimit të saj;
- Stafi i OEGJK-së vizitoi ShKÇAK. Në takim u diskutua lidhur me shërbimet të cilat i ofron ShKÇAK dhe format e bashkëpunimit të cilat kanë për qëllim avancimin e politikave në fushën e menaxhimit financiar për sektorin privat;
- Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, priti në takim Drejtoreshën Ekzekutive të ShKÇAK, znj. Ardiana Bunjaku, me të cilën biseduan për hapa konkret të bashkëpunimit;
Në kuadër të Green and Digital Week të organizuar nga Oda Ekonomike Gjermano- Kosovare, për të diskutuar për ESG (Environmental Social and Governance), si paneliste ishte e ftuar Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK, znj. Ardiana Bunjaku.



ShKÇAK në bashkëpunim me Zyrën e Korporatës Financiare Ndërkombëtare (IFC) në Kosovë, pjesë e Grupit të Bankës Botërore prezentuan Manualin te Falimentimit për biznese tek antarët e ShKÇAK i cili ka për qëllim që të ndihmoj bizneset me njohuri mbi zbatimin e Ligjit të Falimentimit dhe Procedurave të reja. Gjatë këtij viti Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK u emërua anëtare e grupit punues për hartimin dhe finalizimin e Projektligjit për Falimentim nga Ministria e Drejtësisë së Republikës së Kosovës.



Në shënimin e 22 vjetorit të Administratës Tatimore të Kosovës, Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK adresoi mesazhin mbi rëndësinë e punës së ATK ndër vite.



ATK vazhdon ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar tutje efikasitetin dhe aftësimin e kuadrove të së ardhmes brenda institucionit. ShKÇAK në kuadër të projektit të përkrahur nga GIZ çertifikoi 11 zyrtarë të ATK-së, të cilët përfunduan me sukses programin “Trajnimi i Trajnerëve për Raportim Financiar” të modeluar enkas për zyrtarët e ATK.



ShKÇAK ishte pjesë e tryezave nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Këto tryeza kishin për qëllim trajtimin dhe identifikimin e temave me interes për auditimet e performancës për sezonin auditues 2022/2023 si dhe diskutimin mbi mundësitë e bashkëpunimit dhe përfshirjes më të madhe të shoqërisë civile në ngjrtjen e transparencës në procese të auditimit.



ShKÇAK edhe gjatë vitit 2022 i ka dhënë një rëndësi të veçant informimit dhe edukimit të publikut të gjerë lidhur me rëndësinë e profesionit të kontabilitetit dhe auditimit si dhe raportimit të drejtë financiar, duke potencuar që ky profesion është profesion i së ardhmes.



Emisioni “7 ditë me Panxhën”



Emisioni “Programi i Mëngjesit”

ShKÇAK dhe universiteti i Prishtinës e gjatë këtij viti kanë bashkëpunuar ngushtë për ngritjen e kapaciteve për profesionistët e së ardhmes.



Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK – Znj. Ardiana Bunjaku ishte e ftuar në Konferencën e 4-të Shkencore Ndërkombëtare “Doing Business in a Post-pandemic World” të organizuar nga Fakulteti Ekonomik – Universiteti i Prishtinës për të shpalosur përvojën e ShKÇAK ndaj COVID – 19 si Organizatë Profesionale e Kontabilitetit dhe Auditimit.



ShKÇAK ofron mbështetje të Organizatave Profesionale të Kontabilitetit dhe Auditimit në përmbushjen e kërkesave në anëtarësim në FNK /IFAC

Ligji Nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim financiar dhe Auditim, për organizatat profesionale të licencuara në Kosovë ka përcaktuar obligimin ligjor për anëtarësim në FNK/IFAC. Nga organizatat profesionale kërkohet që brenda periudhës tre vjeçare nga hyrja në fuqi e këtij ligji të bëhen anëtare monitoruese, ndërsa brenda pesë viteve nga hyrja në fuqi e ligji të bëhen anëtare me të drejta të plota të FNK/IFAC. Bazuar në këto kërkesa të Ligjit por edhe kritereve për pranim në anëtarësi të FNK/IFAC, ShKÇAK si e vetmja organizatë profesionale e kontabilitetit dhe auditimit në Kosovë anëtare e FNK/IFAC ka shprehur gatishmërinë e saj për mbështetje të organizatave profesionale dhe për këtë qëllim ka nënshkruar marrëveshje me organizatën profesionale IAAB për fillimin e procesit të vlerësimit të pajtueshmërisë së kësaj organizate me standardet ndërkombëtare dhe kërkesat e tjera të përcaktuara për anëtarësim.

Duke pasur parasysh se IAAB ka shprehur gatishmëri të plotë për tu përgjigjur në të gjitha kërkesat e përcaktuara për këtë fazë por edhe të rekomandimeve për përmirësime, mund të konsiderohet se procesi i deritanishëm është i suksesshëm.

Megjithatë, ShKÇAK do të vazhdojë monitorimin e implementimit të standardeve ndërkombëtare dhe kërkesave tjera të FNK/IFAC nga ana IAAB deri në rekomandimin përfundimtar.



BASHKËPUNIMI RAJONAL

SHKÇAK mban kontakte të vazhdueshme me të gjitha organizatat profesionale të rajonit.

Gjatë këtij viti ShKÇAK ka fuqizuar raportet me Bordin e Mbikëqyrjes Publike të Shqipërisë duke nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, i cili ka për qëllim koordinimin për të punuar në arritjen e një partneriteti afatgjatë në lidhje me profesionin e auditimit, trajnimit dhe shërbime të lidhura në organizimin dhe shkëmbimin e kapaciteteve profesionale, për të lehtësuar ndarjen e ekspertizës dhe përvojave lidhur me zhvillimet në profesion në Republikën e Kosovës dhe Republikën e Shqipërisë.



Në kuadër të bashkëpunimeve rajonale në këtë vit, përfaqësues të ShKÇAK së bashku me përfaqësues të IEKA në kuadër të marrëveshjes për realizimin e përkthimeve të standardeve profesionale e Kodit të Etikës, përkthyen dhe publikun :Standardi Ndërkombëtar i Menaxhimit të Cilësisë (ISQM) 1, Menaxhimi i Cilësisë për Firmat që kryejnë auditime ose rishikime të pasqyrave financiare, ose angazhime të tjera të sigurimit ose shërbimeve të ngjashme; Manuali i Kodit Ndërkombëtar të Etikës për Kontabilistët Profesionalistë - duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarësisë (Edicioni 2021).

SHKÇAK AKTIVE NË SFERËN GLOBALE

ShKÇAK vazhdon të jetë aktive si anëtare me të drejta të plota në FNK, EFAA dhe FCM, duke kontribuar në proceset e zhvillimit të profesionit në sferën globale, duke përgatitur komentet në draftet e standardeve të lëshuara nga standard-vënësit global.

ShKÇAK ka marrë pjesë në takimet vjetore të Federatave, në të cilat janë marrë vendime strategjike, aprovim të raporteve vjetore, financiare, buxhetit, planit të punës etj.



ShKÇAK vazhdon të përfaqësohet në grupet e ekspertëve të EFAA përmes, Z. Nazmi Pillana anëtar i Grupit të Ekspertëve të Kontabilitetit dhe Z. Lulzim Zeka anëtar i Grupi të Ekspertëve të Auditimit. Grupet e ekspertëve të EFAA luajnë një rol aktiv dhe të rëndësishëm në përfaqësimin dhe mbrojtjen e interesave të praktikave dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme pranë politikbërësve dhe akterëve tjerë relevant.



ShKÇAK vazhdon të jetë pjesë në Programet e Qendrës për Reforma në Raportim Financiar të Bankës Botërore.

Si pjesë e QRRF-së të Bankës Botërore, përfaqësuesit e ShKÇAK-së së bashku me përfaqësues të KKRF, Thesarit të Republikës së Kosovës, BMP në vazhdimësi kanë qenë pjesë e seminareve dhe punëtorive të organizuara nga kjo qendër.

- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në eventin e organizuar online nga PULSAR/PEMPAL, pranë Qendrës së Bankës Botërore për Reforma në Raportim Financiar (CFRR), me temë: Kontabiliteti dhe Raportimi në sektorin publik.

- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në serinë e uebinarëve të QRRF-së me temë "Transparenca e përmirësuar dhe Raportimi i Qëndrueshmërisë së Korporatës – Zhvillimet e Reja në BE".

- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në seminarin e përbashkët "Rruga drejt akrualeve: "Të dhënat dhe mësimet e mësuara" të organizuar nga programi PULSAR. Në këtë punëtori morrën pjesë rreth 135 pjesëmarrës nga 34 vende.

- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në uebinarin e organizuar nga PULSAR mbi promovimin e librit "Ecuria e reformës së kontabilitetit të sektorit publik në vendet e programit PULSAR"

- Përfaqësues të ShKÇAK së bashku me përfaqësues të Këshillit Kosovar për Raportim Financiar, Thesarit të Republikës së Kosovës, Bordit të Mbikëqyrjes Publike morën pjesë në Seminarin e Zyrtarëve të Lartë: PULSAR, REPARIS për NVM-të, STAREP, i cili u zhvillua në Vjenë, Austri.

- Përfaqësues të ShKÇAK morën pjesë në Konferencën Ministrale e cila u zhvillua në Vjenë, Austri dhe si temë kishte: Raportimi financiar dhe i qëndrueshmërisë për transparencën dhe rimëkëmbjen ekonomike.






Përfaqësues të ShKÇAK së bashku me përfaqësues të MFPT, KKRF, Thesarit të Republikës së Kosovës, BMP morën pjesë në shënimin e 20 vjetorit të QRRF.

Drejtoresha Ekzekutive e ShKÇAK me rastin e 20 vjetorit të QRRF përmes një video mesazhi theksoi “Është kënaqësi e imja që prej 15 vitesh jam pjesë e aktiviteteve të Qendrës së Bankës Botërore për Reforma në Raportim Financiar të Bankës Botërore. Duke qenë se ShKÇAK ishte në vitet e para të zhvillimit si organizatë profesionale, QRRF ka luajtur një rol të madh në ofrimin e ekspertizës së nevojshme përmes transferimit të njohurive teknike për ngritjen e kapaciteteve brenda organizatës sonë. Një pjesë e rëndësishme që kam vlerësuar ishte bashkëpunimi në mes zyrtarëve të lartë, rregullatorëve, organizatave profesionale dhe akademisë nga vendet që po ecnin drejtë të njëjtave synime dhe përballëshin me shumë sfida të përbashkëta. Transferimi i njohurive dhe përvojës teknike nga ekipi dhe ekspertët e QRRF është transformuar drejtpërdrejt në korniza efektive në përputhje me “acquis” dhe përmbushjen e detyrimit të anëtarësimit për t’u bërë anëtarë të FNK/IFAC. Duke thënë këtë, kujtoj se ne festuam me QRRF dhe komunitetin REPARIS anëtarësimin e ShKÇAK në IFAC në vitin 2009. QRRF është një shembull i strukturës inovative të programeve dhe transferimit të njohurive për të na ndihmuar të gjithë ne të mësojmë nga përvoja e njëri-tjetrit me të njëjtin qëllim për të fuqizuar institucionet dhe për të punuar në shërbim të interesit publik. Urime të gjithëve.”

QRRF ka ndihmuar shtetet në zhvillim përmes programeve PULSAR, REPARIS për NVM-të, STAREP të saj për reformat në raportim financiar, kontabilitet, auditim, menaxhim të financave publike si dhe auditimin e brendshëm.

STRUKTURA ORGANIZATIVE E SHKÇAK



STUDENTËT E VITIT

ShKÇAK në vazhdimësi vlerëson përkushtimin që tregojnë anëtarët e Shoqatës gjatë ndjekjes së programeve certifikuese. Edhe për vitin 2022 janë ndarë çmimet për Studentët e vitit si mirënjohje për rezultatet e arritura nga këta studentë, por edhe si inkurajim për studentët e tjerë për të vazhduar me përkushtimin e tyre drejt përfitimit të thirrjeve profesionale që ata i aspirojnë.



YLLI LLONCARI
Auditor i Certifikuar



AGON SALIHU
Kontabilist i Certifikuar



ARB NOR KOSUMI
Teknik i Kontabilitetit



FATMIRE BAJGINCA
Auditor i Brendshëm
i Certifikuar



DIEDON BERISHA
Ekspert i Lartë Tatimor



LULZIM KRASNIQI
Ekspert i Licencuar i
Forenzikes Financiare

RAPORTET E KOMISIONEVE

Komisionet e ShKÇAK-së janë shtylla të rëndësishme në qeverisjen e Shoqatës duke luajtur rol kyç në arritjen dhe zhvillimin e qëllimeve, objektivave dhe aktiviteteve të Shoqatës dhe përmbushjen e objektivave të Deklaratave të Obligimeve të Anëtarësisë (DOA) të FNK-së.

Komisionet e Shoqatës i përcjellin zhvillimet në fushat përkatëse të profesionit në vend dhe në botë dhe angazhohen që objektivat dhe aktivitetet e Shoqatës t'i reflektojnë ato zhvillime në shërbim të interesit publik. Komisionet shërbejnë si urë lidhëse në mes të anëtarëve dhe akterëve relevantë të profesionit në krijimin e një mjedisi të avancuar të punës për kontabilistët dhe auditorët.

Në anën tjetër, Komisionet e ShKÇAK-së përkujdesen për ruajtjen e integritetit profesional të anëtarëve, respektimin e Kodit të Etikës nga ata dhe pajtueshmërinë e punës së tyre me standardet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe auditimit, si dhe të edukimit.



Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale



Komisioni për Tatime



Komisioni për Nominime



Komisioni për Kontabilistë të Certifikuar



Komisioni për Menaxhimin e Cilësisë



Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë

RAPORT NGA KOMISIONI PËR NOMINIME



Të nderuar anëtarë,

Viti 2022 ishte vit zgjedhor për strukturat e rëndësishme të Shoqatës sonë. Komisioni për Nominime në mbështetje të Statutit, Rregullores së Komisionit dhe akteve tjera normative të Shoqatës e ka zhvilluar procesin e nominimit dhe është përkujdesur që i tërë procesi të mbështetet në transparencë të plotë dhe të jetë brenda afateve të përcaktuara.

Komisioni për Nominime edhe këtë vit, duke marrë me seriozitet të madh tërë procesin e nominimeve dhe përfundimisht zgjedhjen e organeve të Shoqatës është përkujdesur që vazhdimisht ti mbajë të informuar anëtarët përmes rikujtimeve për procesin dhe afatet e nominimeve. Qëllimi i Komisionit për nominime në mënyrë permanente është që në këto procese numri i anëtarëve të nominuar të jetë sa më i madh dhe të ketë përfshirje

sa më të madhe të anëtarëve nga kategoritë e ndryshme e me këtë edhe mundësia për zgjedhje të jetë sa më e madhe.

Në këtë aspekt, komisioni konsideron se anëtarët përveç obligimeve tjera që i kanë si anëtarë të Shoqatës e kanë për obligim edhe përfshirjen sa më të gjerë në procesin e nominimeve duke nominuar kolegët e tyre për të cilët mendojnë se në mënyrën më të mirë dhe më profesionale do të zëri i tyre në organet vendimmarrëse të Shoqatës.

Në vitet zgjedhore aktiviteti i Komisionit për Nominime është mjaft i ngjeshur. Këtë aktivitet Komisioni e zhvillon konform planit të punës në të cilin janë të përcaktuara veprimet e Komisionit dhe korniza kohore për realizimin dhe kryerjen e atyre veprimeve dhe e tërë kjo në mbështetje të plotë të Rregullores së Komisionit për Nominime.

Konkretisht, aktiviteti i Komisionit për Nominime në vitin 2022 ka qenë përmbyllja e procesit të nominimeve i filluar në fundin e viti 2021, për anëtarë të Bordit të Shoqatës, Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë dhe Komisionit për Nominime.

Për kënaqësinë e Komisionit, në krahasim me disa vitet e fundit, numri i anëtarëve të nominuar ka shënuar rritje edhe pse jo në nivelin e kënaqshëm.

Komisioni për Nominime ka arritur që brenda afateve të përcaktuara të përfundoj procesin e nominimeve që ka rezultuar me përgatitjen e rekomandimeve për Kuvendin e Anëtarëve në të cilën ju Anëtarë të nderuar me votën tuaj të lirë u keni dhënë mandate anëtarëve të Bordit, Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë dhe Komisionit për Nominime.

Në fund, si Kryesues i komisionit e konsideroj të nevojshme dhe obligim që të drejtohem me kërkesë të mos hezitoni në nominimet tuaja dhe ti jepni vetes por edhe kolegëve tuaj mundësinë që të jeni pjesë e strukturave të Shoqatës dhe të jepni kontributin tuaj të drejtpërdrejt si profesionist të fushave të ndryshme.

Nazmi Pllana - Kryesues i Komisionit për Nominime

RAPORT NGA KOMISIONI PËR SJELLJE DHE DISIPLINË



Të nderuar Anëtarë,

Përmes këtij raporti synojmë të prezantojmë punën e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë gjatë vitit 2022, detyrat e tij, ushtrimin e përgjegjësisë dhe zbatimin e Rregullores së brendshme të punës dhe Statutit të organizatës konform ligjeve në fuqi. Po ashtu, Komisioni ka ndjekur me përpikmëri nevojat e anëtarëve duke iu përgjigjur në kohë dhe profesionalisht çfarëdo kërkesë që ka ardhur dhe informuar ata për të gjitha zhvillimet.

Njëherësh, janë organizuar në vazhdimësi aktivitete në shërbim të anëtarëve të rinj, duke nxjerrë sipas nevojës rekomandime e udhëzime për etikën profesionale. Konform Rregullores në fuqi, Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë ka përbushur planin e punës dhe pritjet e paracaktuara ashtu sikurse është mandatuar nga Kuvendi i ShKÇAK.

Rrjedhimisht, gjatë vitit 2022 Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë nuk ka pasur në shqyrtim shumë raste të shkeljes së etikës dhe rregullave profesionale nga ana e anëtarëve të saj. Kjo situatë flet për kredibilitetin e organizatës, efikasitetin në zbatimin e Statutit dhe Rregullores në fuqi dhe përqafimit të standardeve profesionale të njëjta për të gjithë.

Komisioni ka shqyrtuar një rast duke mbajtur seancë për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore të përcaktuar me Statut dhe Rregullore të Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë. Puna hetimore e anëtarëve të Komisionit është bazuar në Statut dhe Rregullore duke marrë vlerësimet dhe opinionet e të gjitha palëve të përfshira në këtë rast.

Po ashtu, gjatë vitit 2022, Komisioni ka pranuar Fletëparaqitje për shkelje disiplinore mbi dyshimin për shkelje të rregullave të profesionit. Komisioni në pajtim me dispozitat e Statutit dhe akteve tjera normative të Shoqatës ka filluar procesin disiplinor por i cili përkohësisht është ndërprerë pasi me kërkesë të KKRF-së ka kaluar për shqyrtim në Bordin e Mbikëqyrjes Publike/KKRF.

Komisioni ka ardhur në përfundim që t'i kushtohet një vëmendje edhe më e madhe në vitin 2023 zbatimit të "Deklaratës nën zotim për përbushjen e obligimeve". Të gjithë anëtarët duhet t'iu përmbahen parimeve që janë aty. Do të rekomandonim që të lansohet një fushatë informimi për rëndësinë e "Deklaratës nën zotim për përbushjen e obligimeve" dhe informimit sa më të mirë të anëtarëve për pasojat në rast të shkeljes së saj.

Krahas monitorimit të vazhdueshëm të performancës profesionale dhe etike të punës së anëtarëve, Komisioni për Sjellje dhe Disiplinë ka ndjekur edhe një agjendë proaktive me aktivitete në funksion të forcimit edhe më të madh profesional të anëtarëve. Kjo vjen si nevojë e domosdoshme për shkak të rritjes gjithnjë e më shumë të anëtarësisë dhe ndryshimit të legjislacionit në fuqi. Ligjëratat e organizuara me anëtarët e rinj kanë pasur për qëllim ndarjen e mësimave, përvojave dhe njohurive më të fundit sa i përket etikës profesionale, legjislacionit në fuqi dhe praktikave më të mira në vendet e tjera.

Të nxitur nga gjetjet e anketimit paraprak për një nevojë më të madhe të respektimit të etikës profesionale, botimi i Broshurës me përmbledhjen e pikave kryesore të etikës ka gjetur zbatim të madh tek të gjithë anëtarët. Ajo është mirëpritur si një nevojë e domosdoshme dhe është kërkuar të përditësohet sipas rrethanave në vitin 2023.

Si kryesuese e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë i vlerësoj të përmbushura synimet dhe pritjet tona gjatë vitit 2022 në aspekt të përfaqësimit sa më të mirë të anëtarëve; ngritjes profesionale të vazhdueshme të tyre; fuqizimin e rëndësisë së aplikimit të etikës profesionale dhe nxjerrjen e materialeve që kanë për qëllim informimin sa më të mirë për të drejtat e anëtarëve.

Viti 2023 duhet të shërbej për t'i adresuar me urgjencë disa nga gjetjet e këtij viti që kanë të bëjnë me një informim sa më të mirë dhe të drejtpërdrejt të anëtarëve për peshën e përgjegjësisë së profesionit që ushtrojnë. Njëherësh, edhe për pasojat që i bartin në rast të mos respektimit të Statutit, Rregullores dhe etikës profesionale.

Secili anëtar duhet të udhëhiqet nga parimet e larta të etikës profesionale duke forcuar edhe më shumë imazhin e organizatës tonë, të Auditorit dhe Kontabilistit profesional - për çka ne të gjithë duhet të angazhohemi pa dallim.

Kaltrina Kadriu Xhemaj – Kryesuese e Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë

RAPORT NGA KOMISIONI PËR AUDITORË LIGJOR



Komisioni për Auditorë ligjor i ShKÇAK është themeluar me qëllim që të avokojë dhe përfaqësoj interesat e Auditorëve ligjor, anëtarë të Shoqatës. Në kuadër të këtij qëllimi të përgjithshëm, Komisioni përkujdeset që interesat e tyre të përfaqësohen sa më mirë dhe puna e tyre të respektohet. Kjo do ti hap rrugën ofrimit të shërbimeve sa më cilësore nga Auditorët ligjor në shërbim të interesit publik me një zbatim të plotë të standardeve ndërkombëtare.

Komisioni gjatë punës së tij i ka kushtuar rëndësi zhvillimit profesional të Auditorëve ligjor në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional. Në këtë aspekt, Komisioni për sesionet e EVP ka propozuar tema të cilat i ka konsideruar të duhura me qëllim të përditësimit të Auditorëve ligjor me risitë në fushën e auditimit.

Gjithashtu, lidhur me Kërkesat e përvojës praktike për Auditorë të Çertifikuar, Komisioni ka propozuar që auditori mbikëqyrës të përpiloj një raport ku do të përshkruhet vendi i angazhimit dhe numri i auditimeve të kryera nga kandidati për auditor të Çertifikuar. Poashtu, Komisioni e ka ngritur edhe çështjen e rishikimit të formularëve ekzistues varësisht nga ndryshimet dhe kërkesat ligjore dhe të akteve nënligjore.

Gjatë vitit 2022 është bërë përcjellja dhe komentimi i DOA-ve sipas nevojës, përcjellja dhe komentimi i azhurnimeve të SNA-ve dhe standardeve tjera të publikuara nga FNK/IFAC. Në kuadër të bashkëpunimeve është planifikuar bashkëpunimi me Këshillin Kosovar për Raportim Financiar për inkuadrimin dhe aplikimin e Standardeve Ndërkombëtare të Menaxhimit të Cilësisë SNMC. Proces i cili do të vazhdojë dhe gjatë vitit 2023.

ShKÇAK ka zhvilluar disa takime me auditorët ligjor ku janë diskutuar tema me rëndësi për punën dhe angazhimin e tyre. Një prej këtyre temave janë tarifat e auditimit respektivisht përcaktimi i një pragu të tarifave për auditim. Duke e pasur parasysh se puna e Auditorëve Ligjor është me përgjegjësi të madhe që kërkon kujdes dhe përkushtim të lartë profesional, Komisioni konsideron se përcaktimi i një pragu të tarifave është faktor tejet i rëndësishëm për cilësi në procesin e auditimit.

Në kuadër të rekomandimeve mbi reformimin e sistemit të raportimit financiar, janë paraqitur disa çështje të lidhur me Auditorët ligjor e që i referohen kohëzgjatjes së licencës dhe publikimit të listave të auditorëve ligjor dhe firmave ligjore vendore dhe atyre të huaja të auditimit. Në këto rekomandime që i janë dërguar KKRF-së është propozuar që kohëzgjatja e licencave të jetë 3 vite. Ndërsa, lidhur me publikimin e listave është propozuar që të mos ketë ndarje të listave në auditorë ligjor/firma ligjore vendore dhe në ato të huaja pasi që një ndarje e tillë mund tu japi avantazh në treg auditorëve ligjor/firmave të huaja ligjore.

Gjatë vitit 2023 ne do të vazhdojmë që të angazhohemi në të gjitha këto fusha dhe do të vazhdojmë të hulumtojmë edhe në drejtime tjera, në kuadër të kornizës ligjore dhe akteve normative të brendshme, për të parë përmirësuar mjedisin e veprimit të Auditorëve Ligjor në Kosovë.

Lekë Musa - Kryesues i Komisionit për Auditorë Ligjor

RAPORT NGA KOMISIONI PËR PËR KONTABILISTË TË ÇERTIFIKUAR



Të nderuar Anëtarë,

Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar ka për qëllim të siguroj që Kontabilistët e Çertifikuar të ofrojnë shërbime të cilësisë së lartë profesionale në fushën e kontabilitetit dhe raportimit financiar duke implementuar Standardet Ndërkombëtare të Kontabiliteti (SNK) dhe Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar gjatë këtij viti ka realizuar disa aktivitete:

Komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar ka vazhduar të rishiqoj EVP-të e organizuara nga ShKÇAK dhe të selektoj ato të cilat janë të rëndësishme për Kontabilistë të Çertifikuar dhe që ndihmojnë ata në përgatitje të pasqyrave financiare dhe në raportim.

Poashtu gjatë këtij viti janë përpiluar disa pyetsorë për punën e Kontabilistëve, të cilat do të dërgohen tek anëtarët.

Gjatë vitit 2022, komisioni për Kontabilistë të Çertifikuar ka zhvilluar aktivitete me focus në promovimin e rolit të kontabilistëve.

Arbëresha Tuhina – Kryesuese e Komisionit për Kontabilistë të Çertifikuar

RAPORT NGA KOMISIONI PËR EDUKIM DHE STANDARDE PROFESIONALE



Të nderuar Anëtarë,

Gjatë vitit 2022, bazuar në strategjinë e përgjithshme të ShKÇAK, Komisioni për Edukim dhe Standarde Profesionale ka vazhduar aktivitetet sipas planit vjetor.

Komisioni në bashkëpunim me departamentin për edukim dhe standarde të zyrës ekzekutive të ShKÇAK ka punuar në rregulloren për edukim profesional. Rregullorja konsolidon të gjitha politikat dhe procedurat ekzistuese për certifikimet e ofruara nga Shoqata, procedurat lidhur me provimet, edukimin e vazhdueshëm profesional dhe çështje tjera administrative. Rregullorja është miratuar nga Bordi i ShKÇAK në fund të vitit 2022.

Gjatë vitit ka vazhduar puna lidhur me azhurnimin e lëndës së re P12/ Menaxhimi strategjik në biznes që do të implementohet si pjesë e planprogramit

gjatë vitit 2023. Ky ndryshim në planprogram është bërë duke konsideruar zhvillimet aktuale në profesionin tonë dhe me qëllim të përgatitjes së studentëve me kompetenca përkatëse.

Gjatë vitit ka përfunduar përcaktimi i rregullave lidhur me numrin e orëve dhe temave të obligueshme për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional për të gjitha kategoritë e anëtarëve të Shoqatës.

Komisioni ka filluar punën në ri-hartimin e kërkesave për përvojë praktike me qëllim të azhurnimit të fushave kryesore përfshirë periudhën e nevojshme të përmbushjes së përvojës praktike për kandidatët që aspirojnë thirrjet e ndryshme profesionale.

Gjithashtu gjatë këtij viti, Komisioni ka punuar ngushtë me Departamentin e Edukimit për krijimin dhe ofrimin e moduleve specializuese në lëmi të veçanta relevante me profesionin, të cilat pritet të ofrohen gjatë viteve në vijim. Si dhe kanë filluar hapat e parë drejt digjitalizimit të sistemit të vetëdeklarimit të orëve të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional.

Lulzim Zeka - Kryesues i Komisionit për Edukim dhe Standarde Profesionale

RAPORT NGA KOMISIONI PËR MENAXHIM TË CILËSISË NË PAJTUESHMËRI ME STANDARDET



Të nderuar anëtarë,

Viti 2022 ishte një vit i sukseshëm për menaxhimin e cilësisë për pajtueshmëri me standardet. Gjatë këtij viti është realizuar plotësisht plani i punës i Komisionit për MCPS.

Janë rishikuar rreth 60 anëtarë Auditorë Ligjor dhe Auditor/Kontabilistë të certifikuar për pajtueshmëri me standardet profesionale për aktivitetet e vitit të përfunduar më 31.12.2020 dhe të gjitha gjetjet dhe rekomandimet janë komunikuar dhe shqyrtuar me anëtarë.

Komisioni për MCPS ka aprovuar të gjitha Raportet e vlerësimit. Rezultatet e këtij rishikimi për pajtueshmëri me standardet treguan që paraqitja e përgjithshme e pasqyrave financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave kontabël, informacionet shpjeguese dhe shpalosjet janë mesatarisht në

pajtueshmëri me standardet dhe ka nevojë të theksuar për përmirësim.

Edhe këtë vit, janë raportuar aktivitetet vjetore përmes platformës elektronike të raportimit nga anëtarët e shoqatës Auditor Ligjor, Auditor/ Kontabilist të certifikuar dhe Auditor të Brendshëm të certifikuar.

Pas një raportimi të suksesshëm të aktiviteteve vjetore nga anëtarët, Komisioni për MCPS ka aprovuar përzgjedhjen e Auditorëve Ligjor dhe Auditorëve/Kontabilistëve të certifikuar të cilët do të rishikohen për pajtueshmëri me standardet profesionale për aktivitetet e vitit të përfunduar më 31.12.2021.

Gjatë këtij viti departamenti për MCPS ka raportuar te Komisioni për MCPS një rast për dyshim për keqpërdorim të thirrjes profesionale nga ana e një anëtarë të shoqatës. Rast i cili i është deleguar Komisionit për Sjellje dhe Disiplinë.

Komisioni për MCPS falenderon të gjithë anëtarët e përzgjedhur për menaxhim të cilësisë, për bashkëpunimin dhe gatishmërinë e treguar për implementimin e rekomandimeve me qëllim të ngritjes së cilësisë së raportimit financiar dhe auditimit, gjithashtu falenderojmë Departamentin e menaxhimit të cilësisë për pajtueshmëri me standardet (DMCPS) për punën e realizuar gjatë këtij viti duke kontribuar kështu në realizimin e misionit të ShKÇAK-së për mbrojtje të interesit publik.

Mentor Hyseni – Kryesues i Komisionit për Menaxhim të Cilësisë në Pajtueshmëri me Standardet

RAPORT NGA KOMISIONI PËR TATIME



Të nderuar Anëtarë,

Komisioni i Tatimeve gjatë vitit 2022, ka vepruar në pajtim me Rregulloren e Komisionit për Tatime të aprovuar nga Bordi i ShKÇAK, me Planin e punës si dhe në pajtim me kërkesat nga palët e interesit.

Fillimisht Komisioni i Tatimeve kishte dhënë propozimet e veta për planin e EVP për 2022, përfshirë seminar për deklaratimet vjetore në të ardhura personale dhe atyre të korporatave si dhe çështjet që kanë të bëjnë me tvsh në ndërtimtari si dhe dhe momenti i lindjes së detyrimit për tvsh; e drejta e zbritjes së TVSH; rregullimet e zbritjeve të tvsh-së.

Komisioni i Tatimeve ishte angazhuar në debatet e organizuara me odat ekonomike dhe institucione të tjera rreth gjendjes së politikave dhe sistemit tatimor.

Përgatitja e rekomandimeve për Ministrinë e Financave dhe ATK, prezantimi në Takimin e Komisionit të tatimeve në kuadër të Odës Ekonomike Amerikane.

Pjesëmarrja në takimet e Odës Ekonomike Amerikane dhe panelet e ndryshme gjithmonë është përcjellur me komentimin dhe propozimin e ndryshimeve tatimore.

Përgatitja e shkresave për shtyerje të afateve të deklarimit tatimor në Ministrinë e Financave.

Përgatitja e Rekomandimeve mbi ndryshime në legjislacionin aktual tatimor në Kosovë dhe masat tjera për avancimin e shërbimeve ndaj tatimpaguesve.

Diskutimet në panele të Odës Ekonomike Amerikane në prezencë të Komisionit parlamentar për Bugjet të Kuvendit, ATK-së dhe drejtorit të ATK-së.

Në këto takime të rregullta të mbajtura anëtarët e Komisionit kanë paraqitur vërejtjet e tyre sa i përket çështjeve të administrimit nga zyrtarët tatimor dhe çështjeve tjera me interes për Anëtarët e Shoqatës. Duke mbrojtur interesin publik dhe të anëtarësisë e të bizneseve kemi dhënë propozime më qëllim lehtësimi dhe stimulimi tatimor si dhe administrim më të lehtë tatimor për tatimpagues. Komisioni paraprakisht kishte pranuar propozime pas kërkesës drejtuar anëtarësisë së gjerë të ShKÇAK për komente dhe vërejtje në ligjet në fuqi dhe rekomandime për ndryshimet e pritura.

Përmbledhja e propozimeve nga Komisioni i Tatimeve të ShKÇAK që është përgatitë për ndryshimet e pritura të reformës tatimore është si vijon:

- Rekomandimet për ndryshime të normës aktuale të TVSH nga 18% në normë 0%:
- Furnizime të artikujve bazik ushqimor;
- Furnizimet për barnat, aparatet mjekësore dhe kirurgjike si dhe aparatet tjera mjekësore për shfrytëzim ekskluziv të të paafteve;
- Furnizimet për Investimet në Impiantet e energjisë së ripërtritshme;
- Furnizimet për kaldajat me biomasë – dru, pelet, briket, pompat termike, kondicionerët eficientë, stufat individuale me biomasë.

Rekomandimet tjera

- Rekomandimi që të bëhet harmonizimi i Nenit 38, pika 2 e Ligjit për TVSH me Neni 18, pika 2 të Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

TAK dhe TAP

Sipas Ligjit NR. 06/L -105 për tatimin në të ardhurat e korporatave, Neni 8, Të ardhurat e liruara, pushimet tatimore dhe lehtësirat e tjera të veçanta për bizneset që paraqesin projekte dhe investime të reja, përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Ministri.

- të lirohen prodhuesit vendor deri 30% nga TAK për eksportet e prodhimeve të tyre;

- të gjitha kompanitë e sapo themeluara (startups) që kryejnë aktivitete novatore mund të ushtrojnë të drejtën e përjashtimit nga tatimi për një periudhë të caktuar dhe nën kushte të caktuara;

- të pranohet lejim i posaçëm i zhvlerësimit - i përshpejtuar për tatimpaguesit prodhues që eksportojnë prodhimet e tyre;

- të lirohen nga pagesa e tatimit nga TAP tatimpaguesit në lëmin e bujqësisë me qarkullim vjetor nën 30,000.00 EUR me kusht që të punësojnë 3 punëtorë mesatarisht gjatë sezonës 6 mujore;

- bizneset afariste që investojnë në mjete themelore dhe që punësimi mbi 10 punëtorë në 3 vitet e para, të kenë lirime në tatim në shumën aq sa paguajnë tatimin në burim në paga për të njëjtit punëtor gjatë periudhës tatimore.(e ngjashme me Ligjin për sponzorizim) ;

- nxjerrja e UA për TAK në bazë të Ligjit Nr. 06/L-105 për Tatimin në Korporata nxjerrja e Udhëzimit Administrativ për pushimet tatimore për TAK dhe TAP.

Administrim i tatimor

- Zvoglimi i periudhës tatimore të Rivlerësimeve tatimore nga 6 vite në 4 vite;

- Zvoglimi i barrës tatimore nga 6 vite në 4 vite;

- Lehtërimi i ndëshkimeve sipas nenit 62 të Ligjit të bëhet pa ndonjë kërkesë por me rastin e deklaratës korigjuese dhe me rastin e kontrollit me një njohtim paraprak para fillimit të kontrollit tatimor;

- Ndëshkimi prej 1% për mos pagesë në kohë të hiqet pasi për këtë aplikohet interesi;

- Interesi të llogaritet në baza ditore;

Komisioni i Tatimeve në Planin e punës për vitin 2022 kishte paraparë edhe çështjen e zbatimit të Planit për përmirësimin e Integritetit të ATK-së.

Nga pikat që parashiheshin të zbatoheshin në Planin e Integritetit të ATK-se të publikuara, Komisioni ka përcjellur këtë zbatim të Planit dhe ka konstatuar se përveç angazhimeve nga ATK në lehtësim të qasjes sa më të shpejtë për zbatim të masave qeveritare sa i përket pasojave të pandemisë siç janë kreditë dhe stimulimi i pagave, në disa fusha nuk është përmirësuar zotimi nga Plani i përmirësimit të Integritetit të paraqitura në Shtyllën IV pikën 4.1 Rritja e shërbimeve elektronike me afat realizimi deri më 31.03.2021 si:

- Kërkesa për hapje apo mbyllje të llogarive tatimore;

- Kërkesa për çregjistrim nga TVSH;

- Kërkesa për transfer Debi-Kredi;

Integritetit të paraqitura në Shtyllën IV pikën 4.1 Rritja e shërbimeve elektronike me afat realizimi deri më 31.03.2021 si:

- Kërkesa për hapje apo mbyllje të llogarive tatimore;
- Kërkesa për çregjistrim nga TVSH;
- Kërkesa për transfer Debi-Kredi;
- Kërkesa për Certifikatë të Rezidencës;
- Njoftim për transfer të Biznesit;
- Kërkesë për rimbursim të kontributeve pensionale për të vetë-punësuarit;
- Kërkesë për rimbursim të kontributeve pensionale për punëdhënësin;
- Njoftim për hedhjen apo shkatërrimin e mallrave të dala jashtë përdorimit;

Poashtu në edhe zotimi në Planin e Integritetit ishte për mundësinë e gjenerimit të gjendjes përgjithshme të tatimpaguesit nuk ishte zbatuar as gjatë vitit 2022.

Komisionit të Tatimeve ka marrë pjesë në mënyrë aktive në takimet e Komitetit Tatimor në Odën Ekonomike Amerikane duke dhënë propozime rreth ndryshimit të politikave tatimore në Kosovë. Shoqata dhe Komisioni i Tatimeve si gjithëherë bashkëpunimin e ka vazhduar edhe me oda tjera në Kosovë përfshirë edhe pjesëmarrjen në takime në Odën Gjermane Kosovare lidhur me Politikën Fiskale dhe ato të administrimit të tatimeve. Janë përcjell me kohë të gjitha propozimet e komisionit dhe anëtarësisë pranë kësaj ode me qëllim bashkërenditje të veprimeve në ndryshim të politikave nga Qeveria dhe zbatimit të atyre në fuqi sa më drejtë nga ATK por edhe nga Dogana.


Presim që ShKÇAK, Komisionit të Tatimeve dhe anëtarëve tanë, si faktor të rëndësishëm në këtë profesion t'iu mundësohet nga institucionet vendimarrëse një rol shumë më domethënës në bërjen e politikave qeveritare për të qenë një mbrojtës i interesit publik përfshirë edhe interesin ekonomik të komunitetit biznesor përmes lehtësirave të procedurave tatimore dhe atyre biznesore në përgjithësi.

Fahri Breznica – Kryesues i Komisionit për Tatime

TË DHËNA STATISTIKORE 2022

Shërbimet që ofrohen nga anëtarët e ShKÇAK-së

Në grafikun në vijim është paraqitur shpërndarja e shërbimeve nga anëtarët tanë nëpër sektorë të ndryshëm, duke u dalluar shërbimet e auditimit, shërbimet kontabël, këshillimet për tatime, mbajtja e librave kontabël dhe të tjera të ngjashme të përfaqësuar në një gamë të gjerë të sektorëve të punës. Prandaj, ngritja e kapaciteteve në këtë profesion është e domosdoshme në mënyrë që profesionistët të mbulojnë tërë sektorin privat dhe publik.



PËRQINDJA E ANËTARËVE AKTIV TË PUNËSUAR NËPËR SEKTORE


Rezultatet tregojnë se 35% e anëtarëve janë të punësuar në kategorinë Industri/Tregti, ndërkohë që 12% e tyre janë të punësuar në sektorin publik. Po ashtu, 20% e tyre janë partnerë apo punonjës në firma të auditimit dhe kontabilitetit dhe 32% e anëtarëve janë të angazhuar në sektorë të tjerë.

Një numër i konsiderueshëm i anëtarëve tanë janë po ashtu të përfshirë në sektorin Akademi/Edukim, përkatësisht 1% e tyre. Ky përfaqësim ndihmon në përafrimin e kurrikulumeve të kontabilitetit dhe auditimit në mes të edukimit akademik dhe profesional sipas Standardeve Ndërkombëtare të Edukimit në Kontabilitet.

Studentët e regjistruar gjatë vitit 2022

Grafiku i mëposhtëm paraqet numrin e studentëve të ri të cilët janë regjistruar në programet çertifikuese të ShKÇAK.


Gjatë vitit 2022 janë regjistruar në nivelin para kualifikues Teknik i Kontabilitetit 212 studentë. Specifikisht, 103 studentë janë regjistruar në programin për nivelin kualifikues “Kontabilist i Çertifikuar”, 2 studentë janë regjistruar në programin për të marrë titullin “Auditor i Çertifikuar”, në nivelin Auditor i Brendshëm i Çertifikuar janë regjistruar 23 studentë. Ndërsa sa i përket specializimeve, 5 studentë janë regjistruar në nivelin Ekspert i Licencuar i Forenzikës Financiare si dhe 5 studentë janë regjistruar në nivelin Ekspert i Lartë Tatimor.



Titujt e fituar përgjatë viteve

ShKÇAK iu jep studentëve dhe anëtarëve mundësi mjaft të mëdha për t'u treguar të suksesshëm duke ofruar tre afate të provimeve gjatë një viti. Në këtë mënyrë edhe atëherë kur studentët dhe anëtarët nuk arrijnë suksesin e dëshiruar gjatë një afati mund të përgatiten dhe të kenë mundësinë t'i nënshtrohen provimeve një apo dy afate më vonë.


Statistikat e ShKÇAK flasin për një rritje të theksuar të numrit të anëtarëve të çertifikuar nga viti 2020-2022, në të tre nivelet e çertifikimeve, ku vërehet një interesim i shtuar për pjesëmarrje në nivelin Teknik të Kontabilitetit, Kontabilist të Çertifikuar dhe Auditorë të Çertifikuar.



Programi Auditor i Brendshëm i Çertifikuar

Programi specializues për Auditim të Brendshëm ka filluar në vitin 2017 si një specializim i ri shumë nevojshëm dhe i dobishëm si për sektorin privat ashtu dhe për sektorin publik.


Sipas grafikut të mëposhtëm për periudhën 2017-2022 janë regjistruar 230 studentë nga të cilët 101 prej tyre kanë fituar thirrjen Auditor i Brendshëm i Çertifikuar, të cilët profesionalisht janë të gatshëm të ofrojnë ekspertizën e tyre në fushën e Auditimit të Brendshëm në sektorin privat dhe publik.



Pjesëmarrja në profesion sipas gjinisë

Tradicionalisht, profesioni i kontabilitetit dhe auditimit ka qenë i përfaqësuar më shumë nga gjinia mashkullore jo vetëm në vendin tonë por edhe në botë. Megjithatë, në kohët e fundit ka pasur një ndryshim pozitiv në këtë drejtim, duke u ngritur gradualisht numri i ushtruesëve të këtij profesioni nga gjinia femrore.

Grafiku i mëposhtëm tregon se gjatë vitit 2022, përqindja e anëtareve femra të Shoqatës ka qenë 52.3%, ndërsa e anëtarëve meshkuj ka qenë 47.7%. Kështu, krahasuar me vitin 2002 ku pjesëmarrja e femrave si anëtare të shoqatës ka qenë vetëm 14%, viti 2022 vazhdon të mbajë pjesëmarrjen e femrave në epërsi.





**Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar
dhe Auditorëve të Kosovës**

**Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve
të pavarur
Për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2022**



Përmbajtja:

Raporti i auditorëve të pavarur	3
Pasqyra e pozitës financiare	5
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e ndryshimeve në fonde	7
Pasqyra e rrjedhës së parash	8
Shënimet e pasqyrave financiare	9

Raport i Auditorit të Pavarur

Drejtuar: Këshillit të Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës, të cilat përfshijnë Pasqyrën e Pozicionit Financiar më 31 Dhjetor 2022, si dhe Pasqyrën e të Ardhurave, Pasqyrën e Ndryshimeve në Fonde, Pasqyrën e Rrjedhjes së Parasë për vitin e përmbyllur dhe të shënimeve tjera shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të bashkangjitura paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë pozicionin financiar të Shoqatës së kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës më 31 Dhjetor 2022, dhe rezultatit e aktivitetit të saj për fundin e vitit, në përputhje me Standardin Ndërkombëtar për Raportim Financiar për NVM.

Bazat për Opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tej në seksionin e raportit Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare. Ne jemi të pavarur nga Organizata në përputhje me Kodin e Etikës për Kontabilistët Profesionistë (Kodit IESBA), dhe kemi pëmbushur përgjegjësitë tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe atyre të ngarkuar me Qeverisjen e Pasqyrave Financiare
Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për NVM dhe për kontrollat e brendshme të cilat menaxhmenti i vlerëson të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës për vazhdueshmërinë në të ardhmen, duke shpalosur, sipas nevojës, çështjet lidhur me vazhdueshmërinë në të ardhmen dhe përdorimin të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likujdijë Organizatën apo të ndërpresë operimin, apo nuk ka ndonjë alternativ tjetër të mundshme përveç se të bëjë atë. Ata të cilët janë ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Organizatës.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë për të marrë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi janë të lira nga gabimet materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të nxjerrë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk ka garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA-të gjithmonë do të zbulojë gabime materiale kur ato ekzistojnë. Gabimet mund të rrjedhin nga mashtrimet apo gabimet dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose në total, ato në mënyrë të arsyeshme mund të pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra mbi bazën e këtyre pasqyrave financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe mbajmë skepticizmin profesional gjatë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e gabimeve materiale në pasqyrat financiare, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dizajnojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit të përshtatshme për këto rrezeqe, dhe marrim dëshmi të auditimit të mjaftueshme dhe e përshtatshme për të ofruar bazat për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të gabimeve materiale që rezultojnë nga mashtrimi është më i lartë se atij që rrjedh nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehura, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrolleve të brendshme.

- I kuptojmë kontrollet e brendshme relevante për auditimin me qëllim të hartimit të procedurave të auditimit që janë të përshtatshme në rrethanat, por jo për qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshëm të Organizatës.
- I vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjet relevante të bëra nga menaxhmenti.
- Konkludojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të parimit të vazhdueshmërisë së kontabilitetit nga menaxhmenti, duke u bazuar në dëshmitë e siguruar të auditimit, nëse një pasiguri materiale ekziston në lidhje me ngjarjet apo kushteve që mund të hedhë dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e organizatës për të vazhduar në vijimësi. Nëse arrijmë në përfundimin se një pasiguri materiale ekziston, ne jemi të detyruar të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për shpalosjet relevante në pasqyrat financiare apo, nëse shpalosjet e tilla janë të papërshtatshme, të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencat e auditimit të marra deri në datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë që organizata të pushojë së vazhduari në vijimësi.

Ne komunikojmë me ata të ngarkuar me qeverisje lidhur me, në mesin e çështjeve tjera, qasjen e planifikuar dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë çdo mangësi të rëndësishme në kontrollet e brendshme që kemi identifikuar gjatë auditimit.


 Astrit Musa – Auditor i Agjoris
 ACA – Audit & Consulting Associates
 Prishtinë, Kosovë
 26 Janar 2023



PASQYRA E POZITËS FINANCIARE**Me 31 dhjetor 2022***Të gjitha shumat në Euro*

	Shënimet	2022 Euro	2021 Euro
PASURITË			
Pasuritë jo-qarkulluese			
Prona, impiantet dhe pajisjet	3	21,496	26,491
Pasuritë e paprekshme	4	-	1,370
Investimet kapitale		17,010	
		38,506	27,861
Pasuritë qarkulluese			
Stoqet -librat		4,742	5,859
Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera	5	30,035	23,153
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	6	592,429	618,572
		627,206	647,584
TOTAL PASURITË		665,713	675,445
FONDET DHE DETYRIMET			
Fondet			
Teprica e akumuluar e të hyrave		520,470	514,337
Fondi i përgjithshëm		520,470	514,337
DETYRIMET			
Detyrimet afat-shkurta			
Huat që bartin interes	7		2,593
Llogari të pagueshme dhe detyrime tjera	8	19,133	15,599
Të hyrat e shtyra	9	126,110	142,916
		145,243	161,108
TOTAL DETYRIMET		145,243	161,108
TOTAL FONDET DHE DETYRIMET		665,713	675,445


Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i ShKÇAK më 26 Janar 2023 dhe janë nënshkruar nga:

Rina Sejdiu - Mustafa

Zyrtare për Financa


Nazmi Pllana

Kryetar i Bordit



PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE**Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022***Të gjitha shumat në Euro*

	Shënimet	2022 Euro	2021 Euro
Të hyrat operative			
Të hyrat nga edukimi	10	255,970	325,750
Të hyrat nga anëtarësimi	10	131,729	117,154
Të hyrat nga menaxhimi i cilësisë	10	29,450	23,050
Të hyrat nga Dep Konsulencës	10	35,330	8,900
Të hyra tjera	10	13,647	10,180
Totali i të hyrave		466,126	485,034
Shpenzimet			
Shpenzimet administrative	11	(179,485)	(174,505)
Shpenzimet e trajnimit	12	(93,376)	(93,529)
Shpenzimet e provimeve	13	(19,493)	(19,409)
Shërbimi për anetarë	14	(136,776)	(104,258)
Shpenzimet e Dep Konsulencës	15	(30,864)	(20,749)
Totali i shpenzimeve		(459,994)	(412,450)
Teprica e të hyrave		6,133	72,584

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE FONDE**Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022***Të gjitha shumat në Euro*

	Me 31 dhjetor 2022	Me 31 dhjetor 2021
Me 01 janar	514,337	441,753
Ndryshime të tjera në tepricën e akumuluar		
Teprica e të hyrave për vitin	6,133	72,584
Teprica e akumuluar e të hyrave me 31 dhjetor	520,470	514,337

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022
Të gjitha shumat në Euro

	Shënim	2022 Euro	2021 Euro
AKTIVITETET OPERATIVE			
Teprica e të hyrave të vitit		6,133	72,584
Zhvierësimi dhe amortizimi	3.4	7,943	12,823
Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera		(6,883)	(1,360)
Stoqet		1,116	(1,413)
Të pagueshmet tregtare dhe të tjera		3,533	(4,341)
Të hyrat e shtyra		(16,805)	36,878
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(4,964)	115,171
AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerja e pronës, impianteve dhe pajisjeve		(1,576)	(6,090)
Blerja e pasurisë së paprekshme		(17,010)	-
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese		(18,586)	(6,090)
AKTIVITETET FINANCUESE			
Pagesat e kredisë		(2,593)	(7,674)
Paraja neto e përdorur në aktivitetet financuese		(2,593)	(7,674)
Rrjedha neto e parasë për periudhën		(26,143)	101,407
Paraja dhe ekuivalentet e parasë në fillim		618,572	517,165
PARAJA DHE EKVIVALENTË E PARASË NË FUND	9	592,429	618,572

Shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare

Për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2022

Të gjitha shumat në Euro

1. Të përgjithshme

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës ("SHKÇAK" ose "Organizata") është organizatë jo profitabile e themeluar në pajtueshmëri me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/22 dhe Ligji Nr.06/L- 043 për Lirinë e Asocimit në Organizatat Joqeveritare. SHKÇAK është themeluar për qëllim të:

- Profesionalizmit të Ndërsjellë: për të përkrahur, mbrojtur dhe avancuar karakterin, statusin dhe interesat e profesionit të kontabilitetit në përgjithësi dhe të kontabilistëve e auditorëve në veçanti që janë anëtarë të SHKÇAK;
- Rritjes Profesionale: që të lehtësojë mirëmbajtjen dhe zhvillimin e kompetencave të anëtarëve përgjatë karrierës së tyre;
- Integritetit: për të mbajtur nivelin më të lartë të standardeve profesionale dhe integritetit të anëtarëve në interes të komunitetit; dhe
- Përfaqësimit: për të përfaqësuar profesionin në komunitet.

Me 31 dhjetor 2022 dhe 2021, Organizata ka kryer aktivitetet me 14 dhe 16 të punësuar përkatësisht.

2 Politikat e kontabilitetit

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit që janë adoptuar në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Baza e përgatitjes dhe deklarata e pajtueshmërisë

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar për Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Këto pasqyra financiare janë përgatitur në pajtueshmëri me konventën e kostos historike. Pasqyrat Financiare janë përgatitur për vitet e përfunduara me 31 dhjetor 2022 dhe 2021. Të dhënat aktuale dhe karahasuese në këto pasqyra financiare janë të shprehura në Euro, përderisa nuk ceket ndryshe. Kur është e nevojshme zërat krahasues janë harmonizuar konform ndryshimeve të vitit në prezantim.

2.2 Valuta funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është valuta funksionale e organizatës.

2.3 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë balancet e parasë së gatshme dhe ato të depozituara në bankat vendore.

2.4 Shkëmbimet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë regjistruar në pajtueshmëri me normën valide të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitime/humbje.

2.5 Kundërbalancimi (offsetting)

Pasuritë financiare dhe detyrimet janë kundërbalancuar dhe raportuar në bilancin e gjendjes atëherë kur ka të drejtë të imponueshme ligjore për të kundërbalancuar shumat e njohura dhe ka synim të vendoset në baza neto, ose të realizojë pasurinë dhe të shlyejë detyrimin në të njëjtën kohë.

2.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat janë njohur atëherë kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike do të rrjedhin në Organizatë dhe këto benefite të mund të maten besueshëm.

Organizata njeh të ardhurat duke i ngarkuar llojet në vazhdim:

- Tarifat e anëtarisë dhe tarifat e edukimit janë njohur fillimisht kur është lëshuar fatura. Të hyrat janë rregulluar në fund të vitit për të reflektuar vetëm të hyrat e fituara gjatë vitit.
- Të hyrat nga tarifat e edukimit dhe anëtarimit janë shtyrë për pagesat e pranura për paradhënie.

2.7 Prona, impiantet dhe paisjet

Prona, impiantet dhe paisjet janë bartur në kosto historike minus zhvlerësimi i akumuluar. Kostoja historike përfshin të gjitha shpenzimet direkt të atribuueshme në përvetësimin e zëri.

Zhvlerësimi është ngarkuar duke përdorur metodën lineare në normat e paracaktuara në mënyrë që të alokohet kostoja e pronës, impianteve dhe paisjeve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

Në vazhdim është paraqitur jeta e përafërt e përdorimit e aplikuar ndaj zërave të rëndësishëm të pronës, impianteve dhe paisjeve:

2.8 Prona, impiantet dhe paisjet (vazhdim)

	2022	2021
Mobiljet dhe paisjet	2-5 vite	2-5 vite
Paisjet e TI nën 1,000 Euro	3 vite	3 vite
Veturat	5 vite	5 vite

Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të pasurive ose janë njohur si pasuri të ndara, si ka qenë e përshtrashme, vetëm kur është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të lidhura me zërin do të rrjedhin në Organizatë dhe kostoja e zërit mund të matet me besueshmëri. Të gjitha riparimet tjera dhe mirëmbajtja janë ngarkuar në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur. Fitimet dhe humbjet mbi heqjet janë përcaktuar duke krahasuar shumat me vlerat bartëse. Këto janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave.

2.9 Pasuritë e paprekshme

Pasuritë e paprekshme me jetëgjatësi të caktuar të cilat janë blerë veç e veç mbahen me kosto minus amortizimi i akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga dëmtimi. Amortizimi njihet në baza të njëjta përgjatë jetëgjatësisë së vlerësuar të pasurisë.

Pasuritë e pa prekshme të Organizatës përbajnë Softuerë kompjuterik, të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave dhe licence nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK) Gjithashtu këto pasuri përfshijnë koston e përkthimit të librave të programit të auditimit të brendshëm e cila është kapitalizuar si kosto e zhvillimit në pajtueshmëri me SNK 38 Pasuritë e paprekshme.

Amortizimi është ngarkuar duke përdorur metodën drejtvizore brenda pesë viteve përgjatë jetës së tyre të përdorimit.

2.10 Dëmtimi i pasurive të prekshme dhe të paprekshme

Në fund të secilës periudhë raportuese, Organizata rishikon shumat bartëse të pasurive të prekshme dhe të pa prekshme të saj për të përcaktuar nëse ka ndonjë të dëshmi që ato pasuri kanë humbje nga dëmtimi. Nëse ekziston ndonjë informacion i tillë, shumat e rikuperueshme të pasurisë vlerësohet në mënyrë që të përcaktohet masa e humbjeve nga dëmtimi (nëse ka).

Shuma e rikuperueshme është më e lartë se sa vlera e drejtë minus shpenzimet e hudhjes dhe vlera në përdorim. Në vlerësimin e vlerës së përdorimit, rrjedhat e ardhshme të parasë së gatshme janë të skontuara në vlerën e tyre të tanishme duke përdorur normën e skontimit të para-ratimit e cila reflekton vlerësimet aktuale të tregut të vlerës në kohë të parasë dhe riskun specifik të pasurisë për të cilën vlerësimet e rrjedheve të ardhshme të parasë nuk kanë qenë të rregulluara.

Nëse shuma e rikuperueshme e një pasurie vlerësohet të jetë më e vogël se vlera bartëse e saj, vlera bartëse e pasurisë zvogëlohet në shumën e rikuperueshme të saj. Një humbje nga dëmtimi njihet menjëherë në fitim apo humbje, përveç rastit kur pasuria përkatëse mbahet me shumën e rivlerësuar, në këtë rast humbja nga dëmtimi trajtohet si rënje e rivlerësimit. Pasuritë që janë subjekt i amortizimit janë rishikuar për dëmtim kurdo që ngjarjet apo ndryshimet në rrethana tregojnë se vlera bartëse mund të mos rikuperohet. Vlera bartëse e një pasurie është shënuar menjëherë në vlerë të rikuperueshme nëse vlera bartëse e një pasurie është më e lartë se vlera e rikuperueshme që është vlerësuar të jetë. Vlera e rikuperueshme është më e larta e vlerës reale të pasurisë minus kosto e shitjes dhe vlerës në përdorim.

2.11 Grantet

Grantet e Qeverisë njihen në fitim ose humbje në baza sistematike përgjatë periudhës në të cilën Organizata i njeh si shpenzime kostot përkatëse për të cilat grantet janë destinuar për kompensim. Në mënyrë specifike grantet e Qeverisë, për të cilat kushti primar është që Organizata duhet të i përfitoj, konstruktoj apo të i njeh pasuritë jo-qarkulluese si të hyra të shtyra në pasqyrën e pozitës financiare dhe të transferohen në fitim apo humbje në baza sistematike dhe racionale përgjatë jetës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

Grantet janë njohur vetëm kur ka siguri të arsyeshme se:

- Organizata do të përmbushë të gjitha kushtet e bashkangjitura atyre; dhe
- Grantet do të pranohen.

Grantet operative janë njohur si e hyrë përgjatë periudhës së nevojshme për ti lidhur ato me kostot, për të cilat janë menduar të kompensohen, në bazë sistematike. Grantet e shënuara për përvetësimin e pasurive janë shtyrë dhe njohur si e hyrë përgjatë kohës së përdorimit të pasurisë përkatëse.

2.12 Lizingu

Lizingu klasifikohet si lizing financiar sa herë që transferohen në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së pasurisë të dhënë me qira ndaj Kompanisë. Të gjitha kontratat e tjera janë klasifikuar si lizing operativ.

Të drejtat për pasuritë e mbajtura si lizing financiar njihen si pasuri të Organizatës në vlerën e drejtë të pronës së dhënë me lizing (ose, në qoftë se vlera është më e ulët, vlera aktuale e pagesave minimale të lizingut) në fillimin e lizingut. Detyrimi që korrespondon me qiradhënësin është përfshirë në pasqyrën e pozicionit financiar si një detyrim i lizingut financiar. Pagesat e lizingut ndahen mes të pjesës financiare dhe uljes së detyrimit të lizingut në mënyrë që të arrihet një normë konstante e interesit në bilancin e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare zbriten gjatë kalkulimit të fitimit ose humbjes. Pasuritë e mbajtura me lizing financiar janë të përfshira në kuadër të zërit prona, pajisjet dhe impiantet, të cilat zhvlerësohen dhe vlerësohen për dëmtim (humbje nga rënia në vlerë) në të njëjtën mënyrë si pasuritë e tjera në pronësi.

Lizingu i pagueshëm operativ ngarkohet në pasqyrën e të ardhurave në baza lineare përgjatë afatit të kontratës së lizingut.

2.13 Stoqet

Stoqet janë prezantuar me vlerën më të ulët ndërmjet kostos dhe çmimit të shitjes minus kostot e kompletimit dhe shitjes.

2.14 Llogaritë e arkëtueshme dhe të tjera

Shumica e shitjeve janë bërë në bazë të afateve normale të kreditimit, si dhe llogaritë e arkëtueshme nuk bartin interes. Ku kreditimi është zgjatur përtej afateve normale të kreditimit, llogaritë e arkëtueshme maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të arëktueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit.

Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme. Nëse është kështu, një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

2.15 Llogaritë e pagueshme dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme tregtare janë detyrime në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes. Të pagueshmet tregtare të shprehura në monedhë të huaj shprehen në valutën Euro duke përdorur kursin e këmbimit në datën e raportimit. Fitimet ose humbjet e këmbimit valutor janë të përfshira në të ardhurat e tjera apo shpenzimet e tjera.

2.16 Kreditë bankare dhe mbitërheqjet

Shpenzimet e interesit regjistrohen në bazë të metodës së interesit efektiv dhe janë përfshirë në shpenzimet financiare.

2.17 Shpenzimet

Shpenzimet janë njohur kur kanë ndodhur.

2.18 Benefitet e të punësuarve

Organizata kontribon në planet pas pensionale të të punësuarve të saj siç përshkruhen nga legjislacioni i sigurimit i miratuar nga ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Kontributet, e bazuara në paga, u janë bërë organizatës nacionale që janë përgjegjëse për pagesën e pensioneve. Nuk ka detyrim shitesë në lidhje me këto plane dhe kështu këto skema janë konsideruar si plane të definuara të kontributeve. Organizata nuk ka benefite pas pensionale ndaj të punësuarve të saj.

2.19 Tatimi në fitim

SHKÇAK është krijuar si organizatë jo profitabile dhe prandaj, është e linuar nga tatimi në të ardhura të korporatave. SHKÇAK gjatë vitit 2022 nuk ka gjeneruar të hyra tjera nga aktivitetet ekonomike të cilat i nënshtrohen tatimit në të ardhura të korporatave.

Organizata nuk ka njohur ndonjë detyrim apo pasuri të shtyrë tatimor me 31 Dhjetor 2022, siç nuk ka ndryshime të përkohshme ekzistuese në ato data.

2.20 Gjykimet kritike dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në zbatimin e politikave të kontabilitetit të SHKÇAK, të cilat janë përshkruar në shënimin 2 të këtyre pasqyrave financiare nga menaxhmenti kërkohet të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime mbi vlerat bartëse të pasurive dhe detyrimeve që nuk janë lehtë të identifikueshme nga burimet tjera.

3 Prona, impiantet dhe paisjet

	Kompjuterët dhe paisjet tjera	Automjeti	Total
	Euro	Euro	Euro
Kosto			
Më 01 janar 2021	75,196	29,700	104,896
Shtesat gjatë vitit	6,090	-	6,090
Heqjet gjatë vitit	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	81,286	29,700	110,986
Më 01 janar 2022	81,286	29,700	110,986
Shtesat gjatë vitit	1,578	-	1,578
Heqjet gjatë vitit	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	82,864	29,700	112,564
Zhvlerësimi i akumuluar			
Më 01 janar 2021	(70,844)	(8,910)	(79,754)
Zhvlerësimi i vitit	(1,771)	(2,970)	(4,741)
Zhvlerësimi për heqjet gjatë vitit	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	(72,615)	(11,880)	(84,495)
Më 01 janar 2022	(72,615)	(11,880)	(84,495)
Zhvlerësimi i vitit	(3,603)	(2,970)	(6,573)
Zhvlerësimi për heqjet gjatë vitit	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	(76,218)	(14,850)	(91,068)
Vlera neto në libra			
Më 31 dhjetor 2021	8,671	17,820	26,491
Më 31 dhjetor 2022	6,646	14,850	21,496

4 Pasuritë e patrupëzuara

	Softuere kompjuterik	Të drejtat autoriale për shfrytëzimin e librave	Licenca nga autoriteti Kombetar i Kualifikimeve	Total
	Euro	Euro	Euro	Euro
Më 01 janar 2021	42,465	32,275	10,954	85,694
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Heqjet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	42,465	32,275	10,954	85,694
Më 01 janar 2022	42,465	32,275	10,954	85,694
Shtesat gjatë vitit	-	-	-	-
Heqjet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	42,465	32,275	10,954	85,694
Amortizimi i akumuluar				
Më 01 janar 2021	(42,151)	(25,820)	(8,270)	(76,241)
Amortizimi i vitit	(285)	(6,455)	(1,342)	(8,082)
Amortizimi për heqjet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2021	(42,437)	(32,275)	(9,612)	(84,324)
Më 01 janar 2022	(42,437)	(32,275)	(9,612)	(84,324)
Amortizimi i vitit	(29)	-	(1,341)	(1,370)
Amortizimi për heqjet gjatë vitit	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2022	(42,465)	(32,275)	(10,954)	(85,694)
Vlera neto në libra				
Më 31 dhjetor 2021	29	-	1,341	1,370
Më 31 dhjetor 2022	-	-	-	-

5 Llogaritë e arkëtueshme dhe të arkëtueshmet tjera

	2022 Euro	2021 Euro
<i>Të arkëtueshmet dhe të arkëtueshmet tjera</i>		
Të arkëtueshmet nga anëtarët	16,136	12,965
Minus: Lejimi për borxhet e dyshimta nga anëtarët	(1,585)	(1,297)
	14,551	11,668
<i>Të arkëtueshmet tjera</i>		
Parapagimet -E drejta për shfrytëzimin e materialeve nga BPP learning Media (ACCA License Fee)	13,046	11,485
Të arkëtueshmet tjera	2,437	-
	15,484	11,485
Gjithsej	30,035	23,153

6 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	2022	2021
	Euro	Euro
Paraja ne bankë	142,429	368,572
Depozitat afatshkurtëra të afatizuara	450,000	250,000
Gjithsej	592,429	618,572

7 Hua që bartin interes

	2022	2021
	Euro	Euro
Hua nga institucionet financiare lokale	-	2,593
Pjesa qarkulluese	-	2,593
Pjesa jo qarkulluese	-	-
Gjithsej	-	2,593

8 Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet të tjera

	2022	2021
	Euro	Euro
Llogaritë e pagueshme		
Furnitorët	373	430
	373	430
Detyrimet tjera		
Detyrimet për kontribute dhe tatime të mbajtura të të ardhurave personale mbi pagat	9,208	10,457
Detyrimet për shërbime të auditimit	4,230	2,950
Të pagueshmet ndaj punonjësve	298	300
Shpenzimet aktuale dhe të tjera	5,024	1,462
Gjithsej	19,133	15,599

9 Të hyrat e shtyra

Analiza e balances

Me 31 Dhjetor 2022, balanca e të hyrave të shtyra përbëhet si në vazhdim:

	2022	2021
	Euro	Euro
Të hyrat e shtyra të trajnimit, provimeve anëtarësi	126,110	142,916
Gjithsej	126,110	142,916

10 Të hyrat

	2022	2021
	Euro	Euro
Të hyrat nga edukimi		
Regjistrimi	4,270	5,480
Trajnimit- sektori privat	114,649	199,410
Provimet- sektori privat	61,328	62,460
Provimet- sektori publik	-	-
Trajnimit-Auditimi i brendshëm	14,530	12,920
Provimet- Auditimi i brendshëm	4,330	2,850
Trajnimit për specializimet -Ekspert i lartë tatimor dhe Ekspert i Licensuar i Forenzikës financiare	450	2,580
Edukimi i vazhdueshëm profesional	56,413	40,050
Gjithsej të hyrat nga edukimi	255,970	325,750
Të hyrat nga anëtarësi	131,729	117,154
Të hyrat nga kontrolli i cilësisë	29,450	23,050
Të hyrat nga Departamenti i konsulencës	35,330	8,900
Të hyrat tjera	13,647	10,180
Gjithsej	466,126	485,034

11 Shpenzimet administrative

	2022	2021
	Euro	Euro
Pagat	137,303	116,462
Zhvierësimi	6,573	4,741
Amortizimi	1,370	8,082
Qiraja	9,600	10,080
Shërbimet komunale	2,810	2,604
Shpenzime të komunikimit	1,945	1,889
Furnizime të zyrës	3,445	3,089
Shërbime të auditimit	4,230	2,950
Mirembajtje -renovim i zyrës	219	499
Sigurim shëndetësor	2,277	2,408
Shpenzimet e reprezentacionit	1,414	1,081
Shpenzimet e automjetit	2,528	2,367
Orendi dhe Paisje TI	3,329	13,131
Shpenzime tjera	1,355	2,243
Shpenzimet e borxheve të këqija	1,087	2,880
Gjithsej	179,485	174,505

12 Shpenzimet e trajnimit

Shpenzimet e trajnimit për vitin e përfunduar me 31 Dhjetor 2022 dhe 2021 ishin si në vazhdim:

	2022	2021
	Euro	Euro
Mbajtja e trajnimeve	46,677	49,786
Qiraja	14,880	14,400
Printimi	4,134	6,313
Shpenzimet e rymës	1,056	688
Të drejtat autoriale BPP, perkthimi dhe azhurnimi	11,996	14,800
Spektori i auditimit të brendshëm	7,959	5,906
Specializime - Ekspert Tatimor dhe Forenzike Financiare	5,038	-
Tjera	1,637	1,636
Gjithsej	93,376	93,529

13 Shpenzimet e provimeve

	2022	2021
	Euro	Euro
Përpilimi & korigjimi	11,209	10,610
Mbikëqyrja	4,421	4,896
Qiraja	2,160	2,160
Printimi	1,682	1,706
Të tjera	21	36
Gjithsej	19,493	19,409

14 Shërbimi për anëtarë

	2022	2021
	Euro	Euro
Edukimi i vazhdueshëm profesional	3,813	3,531
Bordi dhe komisionet	10,654	9,681
Udhëtimet	5,900	1,956
Takimet vjetore dhe ceremonitë	22,652	3,832
Anëtarësia në organizata	14,889	14,623
Seminare dhe punëtori	-	118
Pagat-shërbimi për anëtarë	36,012	30,944
Zhvillimi i certifikimeve tjera dhe KC	31,449	31,110
Marketingu	602	1,448
IT dhe Web-faqja	2,959	2,958
Të tjera	5,846	4,057
Gjithsej	136,776	104,258

*Shpenzimet e Këshillit dhe Komisioneve përfshijnë kompensimet për takime.

15 Shpenzimet e departamentit të konsulencës

	2022	2021
	Euro	Euro
Shpenzimet e pagave	20,197	20,749
Shpenzimet e projektit GIZ	3,317	-
Due Diligence	7,350	-
Gjithsej	30,864	20,749

16 Zotimet dhe Kontingjentet

Zotimet

Nuk ka zotime më 31 Dhjetor 2022 përveç marrëveshjes së qirasë së zyrës dhe sallave të trajnimit. Pagesa mujore e qirasë për zyrë dhe sala të trajnimeve është 2,600 Euro.

Çështjet gjyqësore

Më 31 Dhjetor 2022 nuk është llogaritur asnjë provizion për humbjet potenciale në lidhje me çështjet gjyqësore. Menaxhmenti i Organizatës, rregullisht analizon rreziqet potenciale që rezultojnë nga humbjet në lidhje me proceset gjyqësore dhe pretendimet e mundshme kundër Organizatës, të cilat mund të dalin në të ardhmen. Edhe pse rezultati i këtyre çështjeve nuk mundet gjithmonë të saktësohet, menaxhmenti i Organizatës beson se nuk ka gjasë që të rezultojë ndonjë detyrim material.

17 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ndonjë ngjarje pas datës së raportimit që kërkon korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare.

GALERIA

ShKÇAK përmbyll vitin 2022 me festën e anëtarëve.





Ceremonia e 20 vjetorit















